



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 16

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 16

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
ISSB	Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MeF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJSHEF	Organizatata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2020),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 16, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	15
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	21
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	23
3.1. Ekonomia e brendshme-----	24
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	26
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	29
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	31
4.1. Aktiviteti bankar -----	33
Anketa e Kreditimit Bankar-----	39
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	44
5.1. Rreziku kreditor -----	47
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit-----	50
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja-----	53
5.4. Kapitali -----	54
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	56
5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test-----	60
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	63
6.1 Sektori Pensional-----	63
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	65
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	69
7. Infrastruktura financiare në Kosovë-----	74
7.1. Sistemi i pagesave -----	74
8. Korniza për Makroprudencë -----	76
8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës -----	76
8.2. Kapitali shtesë kundërciklik -----	76
8.3. Bankat me rëndësi sistemike -----	78
9. Shtojca Statistikore -----	83

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	17
Grafik 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja	17
Grafik 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar	18
Grafik 4. Harta e stabilitetit financiar	21
Grafik 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje	24
Grafik 6. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor	24
Grafik 7. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial	26
Grafik 8. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë	26
Grafik 9. Indeksi i klimës dhe i besueshmërisë së biznesit	26
Grafik 10. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja	27
Grafik 11. Borxhi i ndërmarrjeve	27
Grafik 12. Normat e interesit për ndërmarrjet	28
Grafik 13. Borxhi i ekonomive familjare	29
Grafik 14. Depozitat e ekonomive familjare	29
Grafik 15. Normat e interesit për ekonomitë familjare	30
Grafik 16. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së	31
Grafik 17. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar	31
Grafik 18. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar	32
Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve	34
Grafik 20. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake	34
Grafik 21. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja	35
Grafik 22. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve	35
Grafik 23. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët	35
Grafik 24. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	36
Grafik 25. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	36
Grafik 26. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë	37
Grafik 27. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK	37
Grafik 28. Kredimarrësit fizik dhe juridik sipas llojit dhe klasifikimit kreditor	38
Grafik 29. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: korporatat jofinanciare	38
Grafik 30. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ekonomitë familjare	38
Grafik 31. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve	39
Grafik 32. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve	40
Grafik 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet	41
Grafik 34. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare	41
Grafik 35. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare	42
Grafik 36. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare	42
Grafik 37. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit	43
Grafik 38. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar	43

Grafik 39. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	44
Grafik 40. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kritereve të rreziqeve -----	44
Grafik 41. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	47
Grafik 42. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs) -----	47
Grafik 43. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	48
Grafik 44. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	48
Grafik 45. Kreditë jo-performuese -----	48
Grafik 46. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	49
Grafik 47. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	49
Grafik 48. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	50
Grafik 49. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	50
Grafik 50. Kontribuuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	51
Grafik 51. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	51
Grafik 52. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	51
Grafik 53. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	51
Grafik 54. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	52
Grafik 55. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	52
Grafik 56. Hendeku kumulativ i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	53
Grafik 57. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	53
Grafik 58. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	53
Grafik 59. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	54
Grafik 60. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	54
Grafik 61. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	54
Grafik 62. Struktura e kapitalit rregullator -----	55
Grafik 63. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit -----	55
Grafik 64. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut -----	55
Grafik 65. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut -----	55
Grafik 66. Struktura e financimit -----	56
Grafik 67. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	57
Grafik 68. Struktura e depozitave -----	57
Grafik 69. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	57
Grafik 70. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	58
Grafik 71. Indikatorët e likuiditetit -----	58
Grafik 72. Rezervat e likuiditetit -----	59
Grafik 73. Hendeku i likuiditetit -----	59
Grafik 74. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit-skenari 1 -----	61
Grafik 75. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2 -----	61
Grafik 76. Asetet e sektorit pensional -----	63
Grafik 77. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	63

Grafik 78. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale -----	64
Grafik 79. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	64
Grafik 80. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	65
Grafik 81. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve -----	65
Grafik 82. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	65
Grafik 83. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	66
Grafik 84. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve -----	66
Grafik 85. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	67
Grafik 86. Primet bruto të arkëtuara -----	67
Grafik 87. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	69
Grafik 88. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	69
Grafik 89. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar -----	70
Grafik 90. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	70
Grafik 91. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik -----	71
Grafik 92. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve -----	71
Grafik 93. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	71
Grafik 94. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	72
Grafik 95. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	72
Grafik 96. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	72
Grafik 97. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	73
Grafik 98. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	73
Grafik 99. Hendeku i kreditimit -----	78
Grafik 100. Kapitali shtesë kundër-ciklik -----	78
Grafik 101. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike -----	79
Grafik 102. Kriteri i madhësisë -----	79
Grafik 103. Kriteri i zëvendësueshmërisë -----	80
Grafik 104. Kriteri i ndërlidhjes -----	80
Grafik 105. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit -----	80
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës -----	32
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës -----	33

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar -----	16
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës -----	23
Tabela 3. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare -----	30
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	31
Tabela 5. Rreziqet e sektorit bankar -----	46
Tabela 6. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit -----	61
Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit -----	62

Tabela 8. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	68
Tabela 9. Dëmet e ndodhura, sipas klasave të biznesit-----	68
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së -----	74
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar-----	75
Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	75
Tabela 13. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë.	79

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) i prezanton publikut numrin e 16-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar dhe të rrisë transparencën e nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Dinamikat që e karakterizuan ekonominë globale gjatë vitit 2019 u përkthyen në rritje të rreziqeve për ekonominë dhe tregjet e jashtme financiare, kryesisht si pasojë e rritjes së proteksionizmit, pasigurive gjeopolitike, si dhe pasigurive lidhur me Brexit. Këto dinamika u përkeqësuan tutje me shpalljen e gjendjes pandemike dhe recesionit ekonomik global që pasoi, duke sinjalizuar për rritje të rreziqeve të jashtme me ndikim potencial negativ në ekonominë dhe stabilitetin financiar në vend.

Ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme ekonomike në vitin 2019, përkundër dinamikave të pafavorshme në ekonominë e partnerëve kryesor tregtarë. Sidoqoftë, shpallja e pandemisë në fillim të vitit 2020 ka ndryshuar tërësisht dinamikat në ekonominë e brendshme, ku kriza e paprecedent shëndetësore, ekonomike dhe sociale është përkthyer në rritjen e pasigurive dhe rreziqeve për stabilitetin financiar. Megjithëse efektet e rritjes së rreziqeve ndaj sektorit financiar dhe stabilitetit të tij në afat të shkurtër mund të jenë zbutur nga masat e ndërmarra nga institucionet relevante, në afat të mesëm, rreziqet për sistemin financiar pritet të rriten.

Stabiliteti makroekonomik dhe një mjedis me kushte të favorshme të financimit kanë vazhduar të mbështesin rritjen e kreditimit për sektorin privat edhe gjatë vitit 2019. Sistemi

financiar ka operuar përgjithësisht në një ambient të favorshëm, me rreziqe të ulëta dhe mesatare nga ambienti makroekonomik dhe sektori privat respektivisht. Sektori bankar shënoi rritje të aktivitetit, mbështetur kryesisht nga rritja e kreditimit dhe investimeve në tregun e letrave me vlerë, përderisa treguesit e performancës dhe shëndetit të sektorit bankar qëndruan në nivele të larta.

Edhe sektori pensional u karakterizua me përshpejtim të rritjes në vitin 2019, duke i'u atribuar kthimit të lartë nga investimet dhe të hyrave të qëndrueshme nga kontributdhënësit. Me rritje të aktivitetit dhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara u karakterizua sektori i sigurimeve, megjithëse rritja e nivelit të dëmeve të paguara dhe shpenzimeve operative ndikuan që sektori të operoj me humbje. Në vitin 2019, edhe sektori mikrofinanciar shënoi përshpejtim të aktivitetit dhe performancë të lartë.

BQK ka vazhduar punën në fushën e makroprudencës bazuar në Kornizën Ligjore Makroprudenciale. Gjatë vitit 2019, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit.

Me qëllim të promovimit të stabilitetit financiar, BQK ka vazhduar punën në plotësimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative të sistemit financiar në përgjithësi dhe sektorit bankar në veçanti, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Gjithashtu, industria financiare ka vazhduar trendin e zgjerimit dhe avancimit të shërbimeve digjitale, duke ndikuar në shtrirjen dhe përdorimin më të madh të shërbimeve financiare përmes shërbimeve elektronike të digjitalizuara.

Fehmi MEHMETI

Guvernator

2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Sektori bankar i Kosovës u karakterizua me dinamika pozitive gjatë vitit 2019, ku performanca e lartë pozitive si dhe treguesit e lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit dëshmojnë qëndrueshmërinë e lartë të sektorit. Rritja e kreditimit nga bankat ka vazhduar të mbështesë rritjen ekonomike të vendit. Megjithatë, shpallja e pandemisë Covid-19 pritet të rrisë rreziqet ndaj funksionimit të sektorit dhe të paraqesë sfidë për sektorin financiar në vend. Në periudhë afatshkurtër, rreziqet priten të menaxhohen falë nivelit të lartë të treguesve të shëndetit të sektorit, të mbështetur ndër tjera nga reformat e vazhdueshme rregullative.

Zhvillimet rreth pandemisë kanë ndikuar në rritjen e pasigurive dhe rreziqeve edhe për sektorin financiar dhe stabilitetin financiar. Të gjitha dimensionet e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori financiar janë rritur. Përderisa efektet e rritjes së rreziqeve ndaj sektorit financiar dhe stabilitetit të tij në afat të shkurtër mund të jenë zbutur nga masat ndihmëse qeveritare, kursimet, ndihmat familjare, rezervat institucionale, në afat të mesëm, rreziqet për sektorin do të rriten. Ndërprerja për një kohë e aktivitetit ekonomik dhe sfidat në funksionim normal të ndërmarrjeve kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë ndjeshëm në aftësinë e tyre për realizimin e të ardhurave, e që pashmangërisht do të krijoj vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare dhe kapacitetin absorbues për kreditim. Kjo situatë do të ndikojë edhe mbi punëmarrësit dhe në tërësi mbi të ardhurat e ekonomive familjare, pasi rënia e aktivitetit të

ndërmarrjeve mund të sjellë reduktim të të ardhurave apo ndërprerje të plotë të pagës. Në një efekt zinxhir, kjo gjendje dhe më tej mund të ndikojë në dobësimin e konsumit, në vështirësi për të përmbushur detyrimet financiare, si dhe në kapacitetin për marrje të kredisë duke ndikuar kështu edhe aktivitetin kreditues. Presioni në të ardhurat e pothuajse të gjithë akterëve të sektorit financiar do të rritet - kthimi në investime nga fondet pensionale mund të zvogëlohet, si rezultat i rënies së çmimit të aseteve dhe normave të interesit; ndërprerjet në aktivitetin e sigurimeve do të rrisin presionin në të ardhurat e sektorit; rënia e kreditimit, rritja e rrezikut kreditor dhe rritja e kostos së financimit do të rrisin presionin në të ardhurat e sektorit bankar.

Para shpalljes së pandemisë Covid-19, sektori ishte duke operuar përgjithësisht në një ambient të favorshëm, me rreziqe të ulëta dhe mesatare nga ambienti makroekonomik dhe sektori privat respektivisht. Zhvillimet kreditore treguan dinamika pozitive, me tendenca të ngadalësimit të trendit dyshifror të rritjes kreditore ndër vite, si dhe treguesit e ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve të mundshme ishin në nivele të larta, të cilësuar me rrezik mesatar në raport me trendin e tyre historik (tabela 1).

Zhvillimet në ambientin makroekonomik ishin të favorshme gjatë vitit 2019, duke mbështetur qëndrueshmërinë e sektorit financiar të Kosovës. Sidoqoftë, kjo periudhë është karakterizuar me rritje të pasigurive në nivel global. Rreziqet e shtuara në ekonominë dhe tregjet e jashtme financiare, kryesisht si rezultat i rritjes së proteksionizmit, pasigurive gjeopolitike, si dhe pasigurive lidhur me Brexit kanë ndikuar në ngadalësimin e rritjes ekonomike të Eurozonës dhe shumicës së vendeve të Ballkanit.

Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar*

Rreziqet	Gjysma I-rë 2018	Gjysma II-të 2018	Gjysma I-rë 2019	Gjysma II-rë 2019	Trendi i rrezikut
Rreziku makroekonomik					↓
Pozicioni financiar i sektorit jo-financiar					↓
Zhvillimet kreditore					↓
Qëndrueshmëria e sektorit bankar					↓
	Rrezik i papërfillshëm	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik mbi mesatar	Rrezik i lartë

Burimi: BQK (2020)

Ekonomia e Eurozonës, si partneri kryesor tregtar i Kosovës dhe vendi me origjinën më të lartë të remitencave, ngadalësoi rritjen ekonomike në 1.3 përqind rritje vjetore nga 1.9 përqind. Edhe Ballkani Perëndimor vlerësohet të ketë ngadalësuar rritjen e aktivitetit ekonomik në 3.5 përqind nga 4 përqind në vitin paraprak, si rezultat i reflektimit të pasigurive globale dhe pasigurive politike në shumë prej këtyre vendeve. Për dallim nga Eurozona dhe Ballkani Perëndimorë, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me përshpejtim të rritjes së aktivitetit ekonomik në vitin 2019 falë rritjes së neto eksporteve.

Në vijim, rreziqet ndaj sektorit financiar janë rritur dukshëm si pasojë e shpërthimit të pandemisë Covid-19. Kriza ekonomike e nxitur nga pandemia Covid-19 dhe masat e ndërmarra për parandalimin e saj, pritet të reflektohet në rënie të theksuar ekonomike në nivel global dhe rritje të pasigurive për sistemin financiar. Ekonomia e Eurozonës pritet të shënoj tkurrje të aktivitetit ekonomik më të lartë se gjatë krizës së fundit globale financiare. Kriza e shkaktuar nga Covid-19 por dhe pasiguritë e shtuara politike në vendet e Ballkanit, do të ndikojnë dukshëm ekonomitë e këtyre vendeve. Ekonomia e Kosovës parashihet të ketë rënie ekonomike më të

theksuar, si rezultat i varësisë së saj nga burimet e jashtme të financimit, përkatësisht turizmit dhe eksportit të shërbimeve, si dhe hapësirës së kufizuar fiskale për mbështetje të kërkesës së brendshme si rezultat i eurizimit (mungesës së funksionit të politikës monetare).


Borxhi i sektorit privat ka vazhduar rritjen në vitin 2019, të mbështetur nga rritja dyshifrore e kreditimit të brendshëm, si dhe rritja e borxhit të jashtëm. Stabiliteti makroekonomik si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portfolios kreditore, në një ambient të kushteve të favorshme të financimit, ka mbështetur rritjen e kreditimit për sektorin privat. Rritja e konkurrencës, fokusi strategjik në segmente të caktuara të tregut nga bankat, si dhe përvoja më e gjatë në ndërtim të raporteve me klient ishin faktorë tjerë që vazhduan të mbështesin kreditimin dyshifrorë të sektorit. Stoku i kredisë së ndërmarrjeve nga sektori bankar u rrit për 9.8 përqind, si dhe trendi i rritjes së kredive të reja u përshpejtua në 9.7 përqind nga 4.9 përqind në dhjetor 2018.

Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiarë shënuan rritje prej 14.5 përqind, por që mbesin me peshë të vogël në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve në rreth 2.8 përqind. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve vazhdoi rritjen dhe

* Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut bazohet në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës. Ndërtimi i kësaj table përfshinë shtesë treguesin e Zhvillimeve kreditore dhe atë të Ekspozimeve. Treguesi i Zhvillimeve kreditore përfshinë nën-treguesit si: Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së, Rritja e kreditimit të sektorit privat, Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së, si dhe rritjen në sektorët e veçantë si ai i ndërmarrjeve dhe atë të ekonomive familjare. Përderisa, në llogaritjen e Qëndrueshmërisë së sektorit bankar, përveç treguesve të hartës së Stabilitetit Financiar është shtuar edhe treguesi i Ekspozimeve, i cili matë ekspozimet e sektorit bankar ndaj letrave me vlerë të qeverive, kreditë në valutë, pjesëmarrjen e detyrimeve të jorezidentëve si dhe pozicionet e hapura në valutë.

arriti në 21.2 përqind të gjithsej borxhit. Raporti i kredisë së ndërmarrjeve nga bankat ndaj BPV-së² arriti në 28.1 përqind në dhjetor 2019, rritje prej 1.2 pikë përqindje.


Grafik 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Kreditë e sektorit bankar ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 10.4 përqind, por trendi i rritjes dyshifrore të kredive të reja, në veçanti atyre konsumuese, ndërroi kahje këtë vit. Kreditë e reja u karakterizuan me rënie vjetore prej 1.0 përqind, të ndikuara nga rënia vjetore prej 4.1 përqind e kredive konsumuese. Stoku i kredisë nga institucionet mikrofinanciare u rrit për 23.3 përqind (duke arritur në 13.5 përqind të vlerës së kredive nga bankat).

Grafik 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja



Burimi: BQK (2020)

Borxhi i jashtëm i ekonomive familjare shënoi rritje prej 6.9 përqind dhe arriti në 5.5 përqind të gjithsej borxhit. Në dhjetor 2019, gjithsej borxhi i ekonomive familjare është rritur për 11.5 përqind dhe si përqindje e BPV-së arriti

në 17.7 përqind. Përkundër rritjes, nivelet e borxhit të sektorit privat në raport me BPV-në mbetën më të ulëta në rajon.

Raporti i vlerës së kredisë së sektorit bankar ndaj vlerës së kolateralit, si dhe borxhi ndaj të hyrave, vazhdojnë të mbesin relativisht të ulëta në 29.2 dhe 42.5 përqind respektivisht. Treguesit tjerë të performancës së sektorit privat janë karakterizuar me zhvillime pozitive.

Sektori i ndërmarrjeve është karakterizuar me rritje të vëllimit të prodhimit industrial dhe rritje të qarkullimit në tregtinë me pakicë. Treguesi i klimës si dhe i besueshmërisë së biznesit kanë ndryshuar trendin rënës që i ka karakterizuar gjatë vitit 2018 dhe kanë shënuar rritje në vitin 2019, që sugjerojnë për pritje më optimiste të ndërmarrjeve për aktivitetin ekonomik para shpërthimit të pandemisë Covid-19. Iniciativa ndërmarrëse ka shënuar rritje gjithashtu, e vlerësuar nga rritja e numrit të bizneseve të hapura, por që bilanci neto i bizneseve të hapura dhe të mbyllura ishte më i ulët si rezultat i mbylljes së më shumë bizneseve. Vendimi për vendosjen e taksës 100% ndaj produkteve të Serbisë si dhe Bosnjës e Hercegovinës ka ndikuar në rritje të pasigurive për ndërmarrjet që kanë ndjeshmëri ndaj importeve nga këto vende. Ndërsa, shpërthimi i pandemisë Covid-19 dhe kriza e paprecedent e shkaktuar si pasojë, do të rrisin dukshëm rrezikun për gjithsej sektorin, që do të materializohet me humbje financiare dhe me rënie të aftësisë paguese (rritje të rrezikut kreditor).

Kushtet në tregun e punës janë përmirësuar relativisht ku shkalla e papunësisë ka shënuar rënie, megjithëse një dinamikë shqetësuese në tregun e punës në vend mbetet reduktimi gradual i fuqisë punëtore si pasojë e emigrimit si dhe punësimit të kosovarëve në vendet e BE-së përmes vizave të punës. Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, remitencat u rritën për 6.4 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve³ shënoi rritje vjetore prej 6.8 përqind

² Bazuar në projeksionet e BQK-së për BPV-në vjetore 2019.

³ Të ardhurat nga kompenzimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

Sidoqoftë, dinamikat e ngadalshme të përmirësimit të kushteve të tregut të punës dhe varësia e lartë nga burimet e jashtme të financimit, të cilat karakterizohen me ndjeshmëri më të lartë, paraqesin rrezik për rritje të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare në rrethana të tilla të vazhdimësisë së rritjes së lartë të kredive për këtë sektor. Në veçanti, segmenti më i ndjeshëm në rast të materializimit të ndonjë goditje, siç është pandemia Covid-19, mund të jenë kreditë konsumuese të pa kolateralizuara dhe me afat më të gjatë të maturimit.


Treguesit e performancës dhe shëndetit të sektorit bankar gjatë vitit 2019 qëndruan në nivele të përafërta me vitin paraprak, pa ndonjë zhvillim të theksuar. Profiti i sektorit bankar shënoi rënie vjetore prej 2.0 përqind, të ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve të interesit në depozita. Profiti i sektorit bankar pritet të ballafaqohet me presionin e shkaktuar nga kriza e pandemisë Covid-19. Rënia e kreditimit dhe rritja e nevojës për ndarje të shpenzimeve për provizione për të mbuluar humbjet e mundshme, do të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve. Përkundër rritjes së rrezikut kreditor, presionet e konkurrencës si dhe rënia e mundshme e kërkesës për kredi, do të ndikojnë në kufizimin e mundësive që bankat të rrisin normën e interesit në kredi. Ndërsa, norma veçse e ulët e interesit në depozita, si dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme të cilat nuk bartin shpenzime interesi, bën që mundësitë për efekte pozitive në realizimin e profitit nga menaxhimi i shpenzimeve për interesa, të jenë të kufizuara. Prandaj, duke pasur parasysh këtë dhe deklaratimet e bankave në anketën e kreditimit bankar që sinjalizojnë për rënien e kreditimit dhe rritjen e rrezikut kreditor, pozita aktuale e profitabilitetit do të ballafaqohet me presione rënëse.

Cilësia e portfolios kreditorë ka vazhduar përmirësimin, në veçanti te sektori i ndërmarrjeve, ndikuar nga procesi i shlyerjes së kredive joperformuese nga bilancet e bankave, si dhe nga faktorët tjerë ekonomik e strukturor që kanë përmirësuar aftësinë paguese dhe

mbledhëse të borxheve. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të sektorit bankar u zvogëlua në 2.0 përqind nga 2.7 përqind një vit më parë. Rritja e stokut të kredive prej 10.1 përqind si dhe rënia e stokut të kredive jo performuese për 16.0 përqind ndikuan në rënien e raportit të KJP-ve. Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me përmirësim të cilësisë së portfolios kreditorë në pothuajse të gjitha veprimtaritë ekonomike. Ndërsa, ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje të stokut të kredive joperformuese, por e cila nuk u reflektua në normën e KJP-ve për shkak të normës më të lartë të rritjes së kreditimit për këtë sektor. Shpërthimi i pandemisë Covid-19 si dhe efekti i masave parandaluese të përhapjes së saj në performancën e ndërmarrjeve dhe të hyrat e ekonomive familjare, do të ndikojnë në rritjen e rrezikut kreditor në periudhën në vijim, me efekte afatmesme në strukturën e kredive të sektorit.

Pozita e kapitalit të sektorit në dhjetor 2019 vazhdoi të reflektoj qëndrueshmëri të lartë. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua në 15.8 përqind nga 17.0 përqind.

Grafik 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK (2020)

Kjo rënie reflekton rritjen e aseteve të peshuara me rrezik si pasojë e rritjes së aktivitetit kreditor, krahas rritjes relativisht më të ngadalshme të kapitalit rregullator që u ndikua edhe nga shpërndarja e dividendës nga disa banka. Sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 89.4 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë, që kryesisht rezulton nga profiti i lartë i realizuar dhe ai i mbajtur. Gjenerimi i kapitalit nga burimet e brendshme, pra përmes gjenerimit të profitit, është element i rëndësishëm që në vazhdimësi

siguron mirëmbajtjen e nivelit të lartë të kapitalizimit. Kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19 do të rrisë presionin në nivelin e kapitalit të bankave, duke ndikuar në rritjen e kërkesave për provizione si dhe në nivelin e profitit.

Indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për stabilitet të likuiditetit bankar. Depozitat e sektorit privat shënuan rritje të përshpejtuar prej 16.2 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të ekonomive familjare. Në nivel sektori, depozitat tejkalojnë kreditë për 129.6 përqind. Asetet likuide shënuan rritje, por rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtëra ndikoi në rënien e lehtë të raportit të tyre në 37.6 përqind nga 38.5 një vit më parë. Megjithatë, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra konsiderohet lartë mbi minimumin rregullator prej 25 përqind. Bilanci i rezervave të likuiditetit të bankave komerciale në BQK vazhdon të tejkalojë rezervën e obliguar për 57.0 përqind, përkundër normës negative të interesit në tepriçën e rezervës. Ambienti i normave të ulëta të interesit ka vazhduar të inkurajojë ekonomitë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përshpejtimit të kreditimit afatgjatë rezultoi në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve. Rritja në vazhdimësi e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme dhe zgjerimi i hendekut për periudhën afatshkurtër rritë ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut të financimit në rast të tërheqjes së papritur të depozitave, apo lëvizjen e tyre ndërmjet bankave. Një situatë e tillë mund të paraqes sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave, pavarësisht nivelit aktual të lartë të mjeteve likuide. Kjo marrë parasysh tregun jo të zhvilluar financiar në Kosovë që mund të vonojë shndërrimin e këtyre mjeteve, si p.sh. letrave me vlerë, në mjete të gatshme financiare, si dhe mungesën e instrumenteve të politikës monetare si rezultat i eurorizimit. Në periudhën në vijim, kriza e nxitur nga pandemia Covid-19 mund të rrisë presionin mbi gjendjen e likuiditetit të sektorit përmes efektit të ngadalësimit të

rritjes së depozitave si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik dhe burimeve të jashtme të financimit. Në një periudhë kur kërkesat për financim dhe likuiditet nga sektori privat do të rriten, presioni për menaxhimin e likuiditetit nga bankat mund të rritet. Në mungesë të mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg nga BQK, nevoja për likuiditet dhe financim mund të menaxhohen përmes menaxhimit të rezervave, marrëveshjeve ndërbankare për likuiditet si dhe financimit nga jashtë përmes bankave amë.

Sektori pensional u karakterizua me përshpejtim të rritjes, si rezultat i kthimit të lartë nga investimet dhe të hyrave të qëndrueshme nga kontributdhënësit.

Performanca pozitive financiare prej mjeteve të investuara jashtë vendit erdhi si rezultat i performancës pozitive në tregjet financiare ndërkombëtare, duke qëndruar në kuota pozitive përkundër një tronditjeje të fortë të shënuar në maj të këtij viti. Arkëtimet e reja nga kontribut-dhënësit kanë vazhduar të shënojnë rritje solide. Përderisa strategjia e investimeve të fondeve, që në të kaluarën ishte më shumë e fokusuar në tregun e jashtëm, në këtë periudhë vërehet rritje e investimeve në tregun vendor, gjegjësisht në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe depozitë e afatizuar në sektorin bankar.

Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2019 u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara.

Pavarësisht kësaj, rritja e nivelit të dëmeve të paguara dhe shpenzimeve operative ndikuan që sektori të operoj me humbje. Asetet e sektorit të sigurimeve kanë pjesëmarrje të ulët prej 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar. Sektori vazhdon të jetë i koncentruar kryesisht në sigurime jo-jetë, respektivisht sigurime të detyrueshme ndaj palës së tretë. Niveli i penetrimit mbetet i njëjtë, në 1.4 përqind (primet e shkruara bruto në raport me BPV-në), e i cili vlerësohet relativisht i ulët, sidomos krahasuar me vendet e BE-së, duke reflektuar potencial për zhvillim të mëtutjeshëm.

Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar ka vazhduar të shënoj rritje të lartë, të ndikuar kryesisht nga rritja e kreditimit

dhe aktivitetit të lizingut, që financohen kryesisht nga huamarrjet në sektorin e jashtëm. Sidoqoftë trendi i rritjes u ngadalësua për herë të parë në 5 vitet e fundit. Përkundër rritjes së shpejtë, pesha e tij në nivelin e ndërmjetësimit financiar mbetet e ulët, në 4.2 përqind të asetëve të gjithsej sistemit financiar. Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 20.5 përqind (ngadalësim të rritjes vjetore prej 7.2 pikë përqindje) të orientuar më shumë në sektorin e ekonomive familjare. Normat e larta të interesit me të cilin karakterizohet ky sektor, në mesatare shënuan rënie të lehtë, megjithëse kishte dallime të mëdha në normën e interesit ndërmjet institucioneve (IMF-ve dhe IFJB-ve) dhe produkteve që ofrohen. Sektori ka vazhduar me performancën e lartë financiare, duke shënuar nivel rekord të profitit. Sektori vazhdon të karakterizohet me nivel të ulët të kredive me probleme, të cilat u rritën në 2.6 përqind nga 2.2 përqind një vit më parë. Mbulueshmëria e kredive joperfomuese me provizione shënoi rënie gjithashtu, por vazhdon të mbetet në nivel të kënaqshëm.

Korniza ligjore, rregullative dhe infrastruktura financiare kanë vazhduar progresin në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Gjatë vitit 2019, BQK ka vazhduar punën në plotësimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative të sistemit financiar në përgjithësi dhe sektorit bankar në veçanti, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar.

Gjithashtu, është vazhduar puna në rishikimin e kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme për të përmirësuar informacionin në këtë fushë me peshë të madhe në stabilitetin e sektorit financiar, si dhe në rishikimin e rregullativës në sistemin e pagesave për të reflektuar rëndësinë sistemike të sistemit të pagesave. Gjatë këtij viti është aprovuar rregullorja për riblerje të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, që e autorizon BQK-në të kryejë operacione kreditore me bankat komerciale që operojnë në Kosovë përmes huadhënies së mbështetur në letra me vlerë qeveritare si kolateral.

Infrastruktura financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin teknologjik, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara. Shpërthimi i pandemisë Covid-19 pritet të nxitë përsheptimin e këtij trendi. Njëkohësisht, rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara pritet të rrisë shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut operacional si dhe nevojën për mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku dhe minimizimin e humbjeve të mundshme.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar


Harta e stabilitetit financiar⁴ paraqet zhvillimet në treguesit kryesorë të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës (grafik 4). Viti 2019, në mesatare, është karakterizuar me rënie të rrezikut ndaj stabilitetit financiar nga ambienti makroekonomik i brendshëm dhe i jashtëm, por i cili kishte tendencë të theksuar rritëse në tremujorin e fundit të vitit. Rreziku nga veprimtaria e agjentëve ekonomikë si ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare ka shënuar rënie, ndërsa nga sektori qeveritar është rritur lehtësisht. Treguesit e brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit kanë reflektuar zhvillime të ndryshueshme. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit është karakterizuar me rritje të lehtë të notës së rrezikut, dhe me tendencë rritëse në TM4 2019. Rreziku nga struktura e sektorit bankar ka shënuar rënie graduale. Ndërsa, rënia më e theksuar e rrezikut në këtë periudhë është shënuar në treguesin e likuiditetit dhe financimit, i cili megjithatë vazhdon të ketë notën më të lartë të rrezikut. Përfundimisht, shumica e treguesve qëndrojnë nën nivelin e rrezikut mesatar historik, me përjashtim të treguesit të qeverisë dhe të likuiditetit e financimit.⁵

Rënia e papunësisë në vendet me koncentrimin më të lartë të dërgesave të remitencave, së bashku me rënien e çmimeve të naftës kanë dhënë kontributin pozitiv në rënien e notës së rrezikut nga ambienti i jashtëm makroekonomik. Ndërsa, zhvillimet në të gjithë treguesit e tjerë të ekonomisë së jashtme, si rritja ekonomike më e ngadalësuar e vendeve partnere tregtare të Kosovës, prospektet më pesimiste për aktivitetin ekonomik në Evropë sipas Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në Evropë, si dhe rritja në normat bazë të interesit, kishin kontribut rritës në notën e rrezikut duke zvogëluar kështu efektin pozitiv të rënies së papunësisë dhe të çmimeve të naftës. Në tremujorin e fundit të vitit, pothuajse të gjithë treguesit kontribuuan në rritjen e rrezikut nga ekonomia e jashtme.

Treguesit e ekonomisë së brendshme u karakterizuan me zhvillime pozitive në kontekst të stabilitetit financiar, duke neutralizuar efektin negativ që erdhi nga komponenta e vetme e këtij treguesi - rritja e presioneve inflacioniste. Sidoqoftë, tremujori i fundit i vitit shënoi tendencë të rritjes së

rrezikut, ndikuar nga zgjerimi i hendekut të prodhimit, si rezultat i ngadalësimit të rritjes ekonomike në TM4, si dhe zgjerimit të bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së.

Grafik 4. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2020)

Sektori i ekonomive familjare dhe i ndërmarrjeve u karakterizuan me rënie të rrezikut. Kreditimi për ndërmarrjet vazhdoi rritjen më të lartë në raport me BPV-në, duke ndikuar që hendeku i kreditimit ndaj BPV-së për këtë sektor të kaloj nga rrafshi negativ në atë pozitiv, e që u reflektua me kontribut rritës në notën e rrezikut. Ngadalësimi i rritjes së sektorit të tregtisë dhe bilanci neto pozitiv më i ulët i regjistrimit të ndërmarrjeve gjithashtu kontribuan në rritje të notës së rrezikut. Por, këto zhvillime u neutralizuan plotësisht nga kontributi pozitiv që dhanë treguesit e tjerë si përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore të ndërmarrjeve, indeksi i qarkullimit industrial si dhe rritja e konsiderueshme e indeksit të besueshmërisë së sektorit në gjysmën e dytë të vitit.

Në rënie të rrezikut për sektorin e ekonomive familjare kontribuan të gjithë treguesit përbërës, me përjashtim të treguesit të hendekut të kreditimit, i cili mbeti në nivel të ngjashëm. Kreditimi për ekonomitë familjare ngadalësoi trendin rritës, andaj dhe ngadalësimi i rritjes së BPV-së nuk ndikoi në ndryshim të hendekut si në rastin e ndërmarrjeve. Cilësia e portfolios kreditore të ekonomive familjare vazhdoi trendin e përmirësimit, duke ndikuar në rrezik më të ulët kreditor. Norma e papunësisë shënoi rënie, ndërsa dërgesat e emigrantëve u rritën, duket u reflektuar në të ardhura më të larta për ekonomitë familjare.

Rreziku nga sektori qeveritar shënoi ngritje të lehtë. Zhvillimet kryesore që ndikuan në rritje rreziku

⁴ Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe

anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar rivedime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

⁵ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

ishin rritja e primit të rrezikut sovran (që reflekton zgjerimin e diferencës mes normës së bonove të thesarit të qeverisë Gjermane dhe asaj të Kosovës), rritja e madhësisë së borxhit publik dhe e kostos së borxhit. Në anën tjetër, komponentë me ndikim pozitiv ishin rritja e të hyrave buxhetore ndaj BPV-së, si dhe ngushtimi, në mesatare, i bilancit buxhetor negativ ndaj BPV-së, i cili megjithatë në TM4 tregoi tendencë rritëse.

Rreziku që buron nga struktura e sektorit bankar është karakterizuar me rënie, si rezultat i zhvillimeve pozitive në pothuajse të gjithë komponentët përbërës. Përfundimisht bënë diversifikimi i portfolios së përgjithshme të burimeve të financimit të bankave, që rezultoi më i ulët krahasuar më vitin paraprak. Përmirësimi më i theksuar është shënuar në komponentin e devijimit negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit, që nënkupton që bankat kanë konvergjuar drejt mesatares së normës së kapitalizimit të sektorit, kjo si rezultat i rritjes së normës së kapitalizimit të bankave më të vogla krahas rënies së normës mesatare të kapitalizimit të sektorit. Zhvillimet tjera pozitive përfshijnë rënien e shkallës së koncentrimit të aseteve të tri bankave më të mëdha, rënien e koncentrimit të portfolios kreditore të ndërmarrjeve dhe diversifikimin më të lartë të portfolios së përgjithshme kreditore.

Pozita e kapitalizimit dhe profitabilitetit të sektorit, megjithëse e favorshme përgjatë gjithë vitit, është karakterizuar me rritje të rrezikut. Norma e kapitalizimit të sektorit ka shënuar rënie, duke zvogëluar diferencën ndaj normës minimale rregullative.

Raporti i të hyrave neto nga interesi ndaj aseteve të sektorit, në mesatare, ka shënuar rënie, si rezultat i rritjes më të lartë të aseteve të sektorit në raport me rritjen e të hyrave neto nga interesi. Ngjashëm, ngadalësimi i rritjes së profitit dhe rritja më e ulët e kapitalit aksionar në raport me asetet, ndikuan në rënien e raportit të profitit ndaj aseteve, respektivisht kapitalit aksionar ndaj aseteve. Komponentët me efekt pozitiv në treguesin e kapitalizimit ishin përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore si dhe rënia e ekspozimeve të mëdha në raport me kapitalin e klasit të parë, por që këto të fundit shfaqën tendencë rritëse në tremujorin e fundit të vitit.

Të gjithë komponentët e treguesit të rrezikut të likuiditetit dhe financimit të sektorit patën kontribut pozitiv në uljen më të theksuar të rrezikut me të cilën u karakterizua ky tregues. Rritja më e lartë vjetore e depozitave të ekonomive familjare, si dhe rënia e pjesëmarrjes së detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në burimet e financimit/detyrimet e sektorit, ishin faktorët më me peshë në zbritjen e rrezikut. Përkundër rënies më të theksuar të notës së rrezikut në këtë tregues, devijimi i tij mbi nivelin e mesatares historike vazhdon, si reflektim në masë të madhe i natyrës së komponentëve të përfshirë në tregues.⁶

⁶ Treguesi i normës kredi/depozita ka përcjellë trend natyreshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit, dhe periudhat e fundit reflektojnë raport më të lartë (notë më të lartë rreziku). Ngjashëm, trendi i normës së rritjes së depozitave të ekonomive familjare është karakterizuar me fluktuime të

theksuara përgjatë viteve, duke qenë më i lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyreshëm ka filluar të bie si rezultat i zhvillimit të sektorit, por që përsëri është rritur në periudhat e fundit.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Mjedisi i jashtëm ekonomik është karakterizuar me rritje të pasigurive në vitin 2019. Rritja e proteksionizmit, ngadalësimi i rritjes ekonomike të ekonomisë së Kinës, rritja e pasigurive gjeopolitike, si dhe pasiguria lidhur me Brexit ka ndikuar që aktiviteti ekonomik në Eurozonë

të jetë më i ngadalësuar. Këto zhvillime jo të favorshme janë përcjellë edhe në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat kanë shënuar rritje të ngadalësuar, me përjashtim të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut të cilat shënuan përshpejtim të rritjes ekonomike krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë

Përshkrimi	BPV-ja reale				Norma e papunësisë				Inflacioni			
	2017	2018	2019	2020	2017	2018	2019	2020	2017	2018	2019	2020
Eurozona	2.5	1.9	1.3	-10.2	9.1	8.2	7.6	10.4	1.5	1.8	1.2	0.3
Gjermania	2.5	1.5	0.6	-7.8	3.8	3.4	3.2	3.9	1.7	2.0	1.3	0.3
Franca	2.3	1.8	1.5	-12.5	9.4	9.0	8.5	10.4	1.2	2.1	1.3	0.3
Italia	1.7	0.8	0.3	-12.8	11.3	10.6	10.0	12.7	1.3	1.2	0.6	0.2
Kosova	4.2	3.8	4.2	-12.3	30.5	29.6	25.7	n/a	1.5	1.1	2.7	0.8
Mali i Zi	4.8	5.1	3.5	-9.0	16.1	15.2	15.1	n/a	2.8	2.9	0.5	0.7
Maqedonia e Veriut	1.2	2.7	3.6	-4.0	22.4	20.7	17.3	20.4	2.1	2.3	0.7	-0.9
Serbia	2.1	4.4	4.1	-3.0	13.2	12.7	10.4	13.4	3.2	2.0	1.9	1.4
Shqipëria	3.8	4.1	2.2	-5.0	13.7	12.3	11.5	11.8	3.2	1.8	1.7	2.4

Burimi: BQE, WEO, Eurostat, BQK dhe Agjensitë Statistike të vendeve të rajonit.

Sqarim: projeksioni i BPV-së për Kosovën është realizuar në korrik 2020 nga BQK ndërsa për vendet tjera të rajonit parashikimet janë të FMN-së të realizuara në prill 2020.

Mbyllja e programit të lehtësimit sasior⁷ në kuadër të politikës ekspansioniste monetare të ndjekur nga BQE, si dhe përshkallëzimi i tensioneve tregtare kanë pasur efekte negative në besueshmërinë e bizneseve dhe të individëve në Eurozonë, duke ndikuar në një rritje të aktivitetit ekonomik prej vetëm 1.3 përqind (1.9 përqind në vitin 2018) (tabela 2). Si pasojë e masave të ndërmarra për të luftuar pandeminë COVID-19, ekonomia e Eurozonës pritet të shënojë një rënie të aktivitetit ekonomik prej 10.2 përqind.

Dinamika më të dobëta të aktivitetit ekonomik në Eurozonë janë reflektuar edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Aktiviteti ekonomik në këto vende u karakterizua me rritje mesatare prej 3.5 përqind, që është një normë e ngadalësuar krahasuar me normën prej 4.0 përqind të shënuar në vitin 2018. Dobësimi i kërkesës së

jashtme ka ndikuar negativisht eksportet e rajonit si dhe burimet e jashtme të financimit. Gjithashtu, problemet e shkaktuara nga COVID-19 por edhe pasiguritë e rritura politike në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të pasqyrohen në rënie të mëtejme të besueshmërisë së investitorëve dhe konsumatorëve, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik.

Për dallim nga Eurozona dhe Ballkani Perëndimor, **ekonomia e Kosovës është karakterizuar me përshpejtim të rritjes së aktivitetit ekonomik në vitin 2019. Megjithatë**, rritja e rreziqeve të jashtme dhe të brendshme gjatë vitit 2020, të shkaktuara nga COVID-19, pritet që të reflektohen në rënie të aktivitetit ekonomik përmes rënies së kërkesës brendshme si dhe rritjes së deficitit tregtar.


⁷ Programi i lehtësimit sasior është instrument jo konvencional (jo standard) i masave të politikës monetare ekspansioniste. Banka Qendrore Evropiane ka lansuar programin e lehtësimit sasior në Mars të vitit 2015 përmes blerjes së aseteve (instrumenteve të borxhit dhe të tjera instrumente financiare) në

treg me qëllimin kryesor, stimulimin e rritjes ekonomike përmes rritjes së bazës monetare në treg (që do të realizohej nga rritja e kreditimit me zvogëlimin e normave të interesit), dhe në këtë mënyrë arrijen e nivelit të inflacionit afër caktit të BQE-së prej 2%.

3.1. Ekonomia e brendshme

Pasiguritë e rritura në mjedisin e jashtëm gjatë vitit 2019 nuk janë reflektuar edhe në dinamikën e ekonomisë së vendit, pasi që rritja reale e BPV-së vlerësohet të ketë shënuar përsheptim të rritjes (4.2 përqind) krahasuar me vitin paraprak (3.8 përqind). Përsheptimi i rritjes ekonomike i'u atribuua kryesisht përmirësimit të pozicionit të neto eksporteve, ndërkohë që kërkesa e brendshme shënoi kontribut pozitiv më të ulët kundrejt vitit 2018 (grafik 5).

Grafik 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Përkundër dobësimit të kërkesës së jashtme dhe çmimeve më të ulëta të metaleve në tregjet ndërkombëtare, eksportet e mallrave kanë shënuar rritje të përsheptuar në vitin 2019 përderisa importi i mallrave është karakterizuar me ngadalësim të rritjes. Kjo ka bërë që eksportet neto në terma real të shënojnë ulje të deficitit tregtar prej rreth 0.8 përqind (14.4 përqind rritje në vitin 2018). Të dhënat zyrtare tremujore të publikuara nga ASK sugjerojnë rritje të vlerës së investimeve për 5.7 përqind dhe rritje të konsumit për 2.3 përqind, një aktivitet kryesisht i mbështetur nga rritja e ndërmjetësimit financiar në vend, rritja e remitencave, kompensimi i punëtorëve si dhe impulsit pozitiv fiskal.


Dinamikën në vitin 2020 ndryshuan tërësisht, pas përhapjes së shpejtë të virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së pandemisë nga OBSH. Për të menaxhuar me pandeminë dhe

krizën shëndetësore, ngjashëm me qeveritë në mbarë globin, edhe qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa kufizuese në mars të vitit 2020 si në aspekt të lëvizjes, udhëtimit, aktiviteteve publike dhe jopublike, veprimtarive në disa prej shërbimeve biznesore, etj. Prioritetizimi i shëndetit publik dhe masat kufizuese janë përkthyer në rënie të aktivitetit ekonomik në vend. Kërkesa vendore pritet të tkurret, ndërsa eksportet neto pritet të thellojnë deficitin tregtar dhe rrjedhimisht të rrisin kontributin negativ në BPV.

Përkundër rënies së çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, çmimet në Kosovë kanë shënuar rritje.

Kjo rritje e çmimeve ka filluar që nga tremujori i fundit i vitit 2018 dhe ka vazhduar edhe në gjysmën e parë të vitit 2019, duke u ngadalësuar në gjysmën e dytë të vitit. Rritja e çmimeve në vend i është atribuuar deri në një masë taksës prej 100 përqind në mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, e veçanërisht rritjes së çmimeve të ushqimit. Deri në dhjetor 2019, norma mesatare vjetore e inflacionit e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) ishte 2.7 përqind (1.1 përqind në vitin 2018) (grafik 6).

Grafik 6. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Për vitin 2020, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit pritet të jetë rreth 0.8 përqind. Në linjë me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave komerciale në vend⁸, të cilat

(Dinamikën e Kreditimit Bankar dhe Pritjet e Inflacionit). Bankat raportojnë për pritjet e tyre mbi dinamikën e inflacionit në frekuencë tremujore dhe për tërë vitin.

⁸ Pritjet e bankave mbi dinamikën e çmimeve në Kosovë pranojnë në baza tremujore, në kuadër të anketimit që realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me 9 bankat komerciale që operojnë në Kosovë

sugjerojnë që norma e inflacionit në vitin 2020 do të jetë më e ulët krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2019, dinamikat që e karakterizuan sektorin fiskal rezultuan në rritje më të lartë të hyrave buxhetore (7.5 përqind) kundrejt shpenzimeve buxhetore (7.2 përqind). Përkundër rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore, niveli më i lartë i shpenzimeve, ka ndikuar që deficitin buxhetor të shënoi rritje prej 3.5 përqind dhe të arrijë në 168.4 milionë euro (162.7 milionë euro në vitin 2018). Si përqindje e BPV-së deficitin primar buxhetor ishte 2.3 përqind (2.4 përqind në vitin 2018). Me rritje prej 9.9 përqind u karakterizua edhe borxhi publik, që arriti vlerën prej 1.2 miliardë euro. **Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.5 përqind nga 16.9 përqind sa ishte në vitin 2018.** Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.0 përqind (i cili ka arritur në 791.9 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 1.8 përqind duke arritur në 408.9 milionë euro.

Ekonomia e vendit vazhdon të ballafaqohet me disekuilibër në sektorin e jashtëm. Megjithatë, dinamikat që kanë karakterizuar sektorin e jashtëm gjatë vitit 2019 kanë rezultuar në përmirësim të neto eksporteve, ku deficitin i llogarisë rrjedhëse ka shënuar vlerën prej 410.2 milionë euro (19.4 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2018). **Në raport me BPV-në, deficitin i llogarisë rrjedhëse ka rënë në 5.8 përqind, nga 7.6 përqind sa ishte në vitin 2018.** Ky zvogëlim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore, ndërkohë që edhe deficitin i mallrave ka shënuar rritje të ngadalësuar.

Rritja e eksportit të mallrave si dhe ngadalësimi i rritjes së importit ka ndikuar që **deficitin në tregtinë e mallrave të shënojë rritje prej 4.5 përqind⁹ (11.6 përqind rritje**

në vitin 2018) dhe të arrijë në rreth 3.1 miliardë euro. Në raport me BPV-në, deficitin tregtar i mallrave ka rënë në 44.0 përqind, nga 44.3 përqind sa ishte në vitin 2018. Vlera e eksportit të mallrave ishte 383.5 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.4 përqind (2.8 përqind rënie në vitin 2018).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënojë vlerën prej 926.9 milionë euro, një rritje prej 8.3 përqind krahasuar me vitin 2018. Përmirësimi i bilancit të shërbimeve i atribuohet rritjes së eksportit të shërbimeve prej 7.3 përqind, përderisa importi i shërbimeve shënoi rritje prej 6.2 përqind. Struktura e shërbimeve të importuara dhe eksportuara mbeti pothuajse e pandryshuar nga viti paraprak, e dominuar nga shërbimet e udhëtimit, transportit, shërbimet kompjuterike dhe shërbimet tjera të biznesit. Kufizimet në udhëtim dhe masat e ndërmarra nga qeveritë e vendeve të BE-së për shtetasit e tyre që vizitojnë Kosovën vlerësohet se do të ndikojnë në dekurajimin e diasporës për të vizituar Kosovën gjatë tremujorit të tretë të vitit dhe për pasojë, do të rezultojnë në rënie të eksporteve të shërbimeve dhe aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (mbi 50 përqind e gjithsej eksporteve të shërbimeve realizohet gjatë tremujorit të tretë të çdo viti – nga të cilat rreth 78 përqind janë shërbime të udhëtimit).

Në kuadër të bilancit të pagesave të Kosovës, të ardhurat neto nga kompensimi i punëtorëve¹⁰, që është kategoria kryesore e të ardhurave parësore, shënuan rritje për 8.5 përqind. Gjithashtu, me rritje u karakterizua edhe bilanci i të ardhurave dytësore, kryesisht si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave që përbën edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore. **Flukset hyrëse të remitencave shënuan vlerën prej 851.7 milionë euro në vitin 2019 dhe shënuan një rritje vjetore prej 6.4 përqind.**

⁹ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁰ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficinet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Këtu përfshihen punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe


punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Në vitin 2019, IHD-të e pranuar në Kosovë ishin pothuajse të njëjta me vitin paraprak (271.8 milionë euro). Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i patundshmërisë, qiradhënies dhe aktivitete biznesore si dhe tek sektori i industrisë ndërsa në sektorin e ndërtimitarisë dhe atë të shërbimeve tregtare është shënuar rënie e IHD-ve.

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Zhvillimet në treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për rritje të vëllimit të prodhimit industrial dhe rritje të qarkullimit në tregtinë me pakicë në vitin 2019. Indeksi i peshuar i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, është karakterizuar me rritje vjetore prej 2.6 përqind. Rritja e këtij indeksi ishte më e lartë tek industria nxjerrëse (4.8 përqind), gjë që dëshmohet edhe nga rritja prej 5.9 përqind e vlerës së shtuar në këtë sektor. Tek industria përpunuese rritja e indeksit ishte më e ulët (2.8 përqind) ndërsa tek sektori i furnizimit me ujë dhe ai i furnizimit me rrymë është shënuar rënie prej 2.0 përqind përkatësisht 1.0 përqind (grafik 7).


Grafik 7. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)



Burimi: ASK (2020)

Mesatarja e indeksit të qarkullimit në tregtinë me pakicë ka shënuar rritje prej 2.7 përqind, që është normë pothuajse e ngjashme me sektorin e industrisë (grafik 8). Rritje prej 5.7 përqind është shënuar edhe tek vlera e shtuar e këtij sektori.


Grafik 8. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2013=100)



Burimi: ASK (2020)

Treguesi klimës së biznesit dhe ai i besueshmërisë kanë ndryshuar trendin rënës që i ka karakterizuar gjatë vitit 2018 dhe kanë shënuar rritje në vitin 2019.¹¹ Treguesi i klimës së biznesit, i cili vlerëson situatën aktuale ekonomike (profitabilitetin) të biznesit dhe pritjet për periudhën e ardhshme gjashtëmuajore, ishte më i lartë për mesatarisht 9.0 pikë përqindje, ndërsa treguesi i besueshmërisë së biznesit, i cili ka karakter më të përgjithshëm vlerësues për gjendjen e biznesit për dallim nga treguesi paraprak që fokusohet vetëm në performancën financiare të biznesit, ishte më i lartë për mesatarisht 5.0 pikë përqindje (grafik 9).

Grafik 9. Indeksi i klimës dhe i besueshmërisë së biznesit



Burimi: OEK (2020)


Si rezultat i rritjes së treguesve të klimës së biznesit dhe besueshmërisë së bizneseve edhe iniciativa ndërmarrëse ka shënuar rritje. Në vitin 2019 u regjistruan 10,004 ndërmarrje të reja, që paraqet rritje vjetore prej 2.0 përqind. Sektorët të cilët shënuan rritjen më të lartë vjetore në numrin e bizneseve të regjistruara ishin prodhimi, hoteleria, aktivitetet profesionale, etj., ndërsa

¹¹ Treguesi i klimës së biznesit dhe ai i besueshmërisë së biznesit përpilohen nga Oda Ekonomike e Kosovës, si pjesë e studimit të rregullit

tremujorë 'Klima e biznesit në Kosovë' i cili anketon bizneset në katër sektorë të ekonomisë: prodhim, ndërtim, shërbime dhe tregti.

në sektorin e bujqësisë dhe atë të tregtisë numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte dukshëm më i ulët (grafik 10).

Grafik 10. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja




Përveç rritjes së numrit të bizneseve të reja të regjistruara, rritje është shënuar edhe në numrin e bizneseve të mbyllura. Gjatë vitit 2019 u mbyllën 1,769 ndërmarrje, apo 24.1 përqind më shumë krahasuar me vitin 2018.

Progresi i vazhdueshëm në zbatimin efikas të reformave të kërkesave legislative dhe rregullative ka kontribuar në zvogëlimin e barrierave për qasjen në kredi, por sfida të shumta vazhdojnë të mbesin. Progresi në fushëveprimin e përmbauesve privat si dhe ndryshimeve në Ligjin mbi Procedurën e Përmbaimit që ka të bëjë me sekuestrimin e llogarisë bankare dhe procedurën e përshpejtuar të shitjes së kolateralit ka ndikuar pozitivisht në ofertën kreditore dhe ka bërë që të lehtësohen kërkesat për kolateral dhe të reduktohen normat e interesit. Sidoqoftë, pengesa të shumta mbesin, të cilat pengojnë performancën e biznesit dhe qasjen në financa. Niveli i lartë i informalitetit, zbatimi i dobët i kontratave, mungesa e të dhënave kadastrale, së bashku me mungesën e transparencës financiare dhe cilësinë e ulët të raportimit financiar, vazhdojnë të jenë pengesë në qasjen në financim për ndërmarrjet.

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar të rritet. Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi ndaj sektorit bankar në vend është rritur për 10.0 përqind

në vitin 2019. Kreditë e ndërmarrjeve të lëshuara nga ndërmjetësit tjerë financiarë shënuan rritje prej 14.5 përqind, por që mbesin me peshë të vogël në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve në rreth 2.8 përqind.

Grafik 11. Borxhi i ndërmarrjeve



Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve vazhdoi rritjen dhe arriti në 21.2 përqind të gjithsej borxhit. Gjithsej borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 10.2 përqind dhe arriti në 35.7 përqind të BPV-së (grafik 11).

Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në procesin e përafrimit të shkallës së ndërmjetësitit financiar drejt vendeve të rajonit. Raporti i kredisë së ndërmarrjeve nga bankat ndaj BPV-së arriti në 28.1 përqind në dhjetor 2019 (26.9 përqind në vitin 2018). Kjo nënkupton se kreditimi është rritur me ritëm më të shpejtë se BPV-ja duke ndikuar që hendeku i kredisë ndaj BPV-së të jetë pozitivë.¹²

Si rezultat i rritjes më të lartë të depozitave, pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje të ngadalësuar. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan normë të rritjes më të përshpejtuar vjetore (25.0 përqind) ndërsa norma e rritjes së kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve ishte më e ngadalësuar (10.0 përqind) dhe kjo ndikoi që ndërmarrjet të shënojnë rritje të pozicionit të tyre debitor ndaj sektorit bankar për 2.6 përqind (10.3 përqind rritje në vitin 2018). Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë,

¹² Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

pozicioni në valutë mbetet i ulët si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të kredive dhe depozitave në valutë, në 0.1 përqind për kredite në valutë ndaj gjithsej kredive, dhe 2.0 përqind për depozitat në valutë ndaj gjithsej depozitave të ndërmarrjeve.


Gatishmëria e sektorit bankar për të kredituar ndërmarrjet ka shënuar rritje më të lartë krahasuar me vitin paraprak. Kreditë e reja u rritën për 9.7 përqind (4.9 përqind në vitin 2018). Sipas qëllimit, kredite e reja jo-investuese shënuan rritje prej 28.1 përqind dhe e shtuan pjesëmarrjen në strukturë nga 34.0 përqind në 39.7 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Kreditë e reja investuese shënuan rritje prej vetëm 1.0 përqind dhe e zvogëluan pjesëmarrjen në strukturë nga 63.6 përqind në 58.5 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Në aspektin e maturimit, viti 2019 u karakterizua me rritje të kredive me maturitet prej 2 deri në 5 vjet, ku 52.0 përqind e kredive të reja i përkisnin kësaj kategorie (46.4 përqind në vitin 2018). Edhe kredite me afat më të shkurtër shënuan rritje në strukturë, ndërsa kredite me afat prej 5 deri në 10 vite shënuan rënie nga 27.1 përqind në 15.9 përqind në strukturën e përgjithshme të kredite e reja për ndërmarrje.

Huamarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2019 është mbështetur edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. FKGK, i cili synon rritjen e qasjes në financa për NVM-të përmes garantimit të portfolios kreditorë të institucioneve financiare, filloi me garantimin e kredisë së parë për NMVM-të në shtator të vitit 2016. Në dhjetor 2019, numri i kredive të bankave të garantuara nga FKGK ishte 4,052 ndërsa shuma e miratuar e garancive arriti në 75.2 milionë euro. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësimit i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, ku dominojnë kredite për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësim

prej 10 përqind në gjithsej portfolion e kredive të garantuara. Prospektet pozitive të zhvillimit të FKGK-së, si në aspektin e rritjes së kapitalit dhe vlerës së garantuar të kredive, ashtu edhe në fokusimin në mbështetjen e sektorëve specifik me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritet të reflektohen në lehtësimin e kushteve të kreditimit dhe rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi, dhe sektorë të caktuar në veçanti. Dinamikat e ndryshuara gjatë vitit 2020 dhe përballja me krizën e paprecedent ekonomike dhe sociale si pasojë e masave të ndërmarrja për të menaxhuar krizën shëndetësore, kanë fuqizuar tutje rolin e FKGK-së në mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike përmes lehtësimit të qasjes në financa. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Bankën Botërore kanë paraparë rritjen e kapitalit të fondit dhe krijimin e dritareve të reja garantuese për sektor të caktuar që rezultojnë të jenë prekur më shumë nga pandemia si sektori i prodhimit, ndërmarrësit e rinj, gratë në biznes, etj.

Kostoja e huamarrjes për sektorin e ndërmarrjeve ka shënuar një ngritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 12. Normat e interesit për ndërmarrjet




Norma mesatare e interesit në kredite e reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 6.32 përqind, nivel paksa më i lartë krahasuar me vitin 2018 (6.28 përqind) Ky nivel i normave të interesit ka ardhur si rezultat i presioneve të vazhdueshme konkurruese, përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditorë, progresi në reformat strukturore për zvogëlimin e rreziqeve në realizimin e kolateralit si dhe qasjes së mirë në financim.

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare, sikurse ai i ndërmarrjeve, është rritur në vitin 2019. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar ka shënuar rritje prej 10.3 përqind, ndërsa borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare, që ka arritur në 13.5 përqind të vlerës së borxhit ndaj sektorit bankar, është rritur për 23.3 përqind. Borxhi i jashtëm i ekonomive familjare shënoi rritje prej 6.9 përqind dhe përbënë 5.5 përqind të gjithsej borxhit. Gjithsej borxhi i ekonomive familjare është rritur për 11.5 përqind dhe si përqindje e BPV-së ishte 17.7 përqind (grafik 13).

Grafik 13. Borxhi i ekonomive familjare



Burimi: BQK (2020)


Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare shënuan rënie. Gjithsej rritja e borxhit të ri ndaj bankave ishte më e ulët për 1.0 përqind, krahasuar me vitin 2018 kur ishte shënuar rritje për 7.1 përqind. Sipas qëllimit, kreditë e reja konsumuese ishin më të ulëta për 4.1 përqind krahasuar me vitin 2018, ndërsa kreditë investuese ishin më të ulëta për 1.9 përqind. Në anën tjetër, kreditë hipotekare shënuan rritje prej 9.5 përqind.

Rënia e kredive konsumuese ndikoi që pjesëmarrja e lartë e këtyre kredive në gjithsej kreditë e reja për ekonomitë familjare të zvogëlohet në 71.7 përqind nga 74.0 përqind sa ishte në vitin 2018.

Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje si rezultat i volumit më të madh të depozitave krahasuar me kreditë por

edhe normës më të lartë të rritjes së depozitave të ekonomive familjare krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 14. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2020)


Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 2.6 miliardë euro¹³, që paraqet rritje vjetore prej 11.5 përqind (grafik 14). Gjithashtu, kreditë vazhduan rritjen dyshifrore prej 10.3 përqind dhe arritën vlerën 1.1 miliardë euro. Si rezultat, pozicioni kreditor që tradicionalisht e kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 12.3 përqind në vitin 2019.

Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rënie të pozicionit të tij kreditor në valutë për 1.4 përqind, si rezultat i rënies së depozitave në valutë, të cilat ranë në 5.8 përqind të gjithsej depozitave të ekonomive familjare (6.0 përqind në vitin 2018), përderisa kreditimi në valutë mbetet në nivel prej rreth 0.2 përqind të gjithsej kredisë për ekonomitë familjare.

Kursimet e ekonomive familjare, në formë të depozitave të kursimit, depozitave të afatizuara dhe depozitave të transferueshme, shënuan rritje në vitin 2019. Kjo rritje e depozitave ka ardhur si rezultat i ngritjes graduale të normës së interesit në depozita e cila ka ndikuar në zvogëlimin e kostos oportune të mbajtjes së kursimeve dhe afatizimit të mjeteve, gjegjësisht në rritjen e kursimeve të ekonomive familjare (grafik 15).

¹³ Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

Grafik 15. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2020)

Gjithsej depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 11.5 përqind (7.9 përqind rritje në vitin 2018). Depozitat e afatizuara shënuan rritje prej 10.3 përqind, ndërsa norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara ishte 1.35 përqind në vitin 2019 apo 0.13 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2018. Edhe depozitat e kursimit shënuan rritje prej 6.3 përqind

ndërkohë që norma e interesit në depozita të kursimit arrit në 0.35 përqind (0.28 përqind në vitin 2018).

Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare vazhdoi rënien, ndikuar nga presionet konkurruese si dhe kushtet e favorshme të financimit. Kreditë konsumuese shënuan normë mesatare interesi prej 7.0 përqind (7.5 përqind në vitin 2018), ndërsa normat e interesit tek kreditë hipotekare ranë në 5.7 përqind (6.0 përqind në vitin 2018). Normat e interesit për ekonomitë familjare pritet të shënojnë rënie akoma më tej, nën prospektet negative të rritjes ekonomike. Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, remitencat u rritën për 6.4 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve¹⁴ shënoi rritje vjetore prej 6.8 përqind.

Tabela 3. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	799.5	900.6	1,001.1	1,104.7
prej të cilave në valutë	2.9	3.0	2.6	2.6
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,120.5	2,164.2	2,334.2	2,601.9
prej të cilave në valutë	100.8	122.6	140.4	138.5
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,321.0	1,263.5	1,333.1	1,497.3
Raporti i borxhit ndaj të hyrave		26.3%*	38.3%	42.5%
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	2,409.5	2,522.1	2,901.0	3,041.4
Shkalla e varësisë ekonomike	274.0%	250.0%	268.0%	253.0%

Burimi: BQK (2020)

* Treguesi i borxhit ndaj të ardhurave të ekonomisë familjare ka filluar të raportohet në mënyrë të rregullt dhe me metodologji konsistente nga bankat duke filluar nga viti 2018.

Niveli i pagave për periudhën 2012-2018, sipas ASK-së, ka shënuar rritje si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, ku në mesatare paga neto është rritur për 29.8 përqind duke arritur në 498 euro në vitin 2018. Në vitin 2019, paga mujore neto, sipas Anketës së Fuqisë Punëtoresh¹⁵, ishte në intervalin 400 deri në 500 euro. Sa i përket tregut të punës, shkalla pjesëmarrjes në fuqinë punëtoresh në vitin 2019 ishte 40.5 përqind apo 0.4 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak, pra është rritur shkalla e jo aktivitetit për 0.4 pikë përqindje dhe ka arritur në 59.5 përqind. Shkalla e punësimit ka arritur në 30.1 përqind që është për 1.3 pikë përqind më e lartë krahasuar me vitin 2018. Në anën tjetër, shkalla

e papunësisë ishte 25.7 përqind apo 3.9 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2018. **Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare, e matur përmes treguesit të borxhit ndaj të ardhurave neto është rritur në 42.5 përqind (38.3 përqind në 2018).** Ky tregues nuk paraqet ngarkesën e plotë të borxhit meqë konsideron vetëm borxhin nga një institucion bankar, duke mos konsideruar huamarrjen e shumëfishtë në banka dhe nga institucionet tjera financiare, si dhe borxhin e jashtëm. Në anën tjetër, treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin midis popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, në vitin 2019 është përmirësuar në 253 përqind, nga 268 përqind sa ishte në vitin 2018.¹⁶

¹⁴ Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.


¹⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqise-punetore-afp-2019.pdf>

¹⁶ Sipas ASK, shkalla projektuar e varësisë ekonomike në BE do të rritet në 122.2 përqind në vitin 2023.

4. Zhvillimet në sistemin financiar

Sistemi financiar në vitin 2019 shënoi rritje të theksuar të aktivitetit, me kontribut pozitiv nga të gjithë sektorët përbërës. Vlera e asetëve të sistemit financiar arriti në 7.26 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 14.9 përqind (rritje prej 6.9 përqind në vitin 2018). Zhvillimet pozitive të sistemit financiar sugjerojnë shtrirje më të madhe të qasjes në shërbime financiare nga ana e publikut, posaçërisht shërbimeve bankare. Shkalla e ndërmjetësimit financiar (raporti i asetëve ndaj BPV-së) u rrit për 8.6 pikë përqindje, në 102.5 përqind, ndikuar nga niveli i shtrirjes së sektorit bankar, por pa përjashtuar dhe ndikimin nga sektori pensional dhe mikrofinanciar (grafik 16).

Grafik 16. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së



Rritja e asetëve të sektorit bankar dhe mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditor të tyre që kryesisht i atribuohet përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së kredive, rritjes së konkurrencës dhe përmirësimit të qasjes në financim. Rritja e asetëve të sektorit pensional u mundësua nga kthimi pozitiv nga investimet si dhe rritja e

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Bankat komerciale	8	8	9	9	10	10	10	10	10	10
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13	14	15	15	15	14	13
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	17	20	17	17	18	18	16	18	22	20
Ndihmësit financiar	28	34	38	39	42	44	48	52	51	51

Burimi: BQK (2020)

kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe. Sektori i sigurimeve shënoi poashtu rritje të asetëve, ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit të depozitave të mbajtura në BQK, investimeve në letra me vlerë si dhe kategorisë huatë dhe të arkëtueshmet.

Sa i përket strukturës së sistemit financiar, numri i bankave komerciale dhe fondeve të pensioneve mbeti i pandryshuar nga viti i kaluar. Përderisa, numri i institucioneve mikrofinanciare gjatë vitit 2019 u zvogëlua në 20 institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jo-bankare si pasojë e revokimit të regjistrimit të dy institucioneve mikrofinanciare. Gjithashtu, numri i kompanive të sigurimit u zvogëlua në 13, si pasojë e revokimit të licencës së një siguruesi (tabela 3). Ndërsa, ndihmësit financiarë kanë numrin më të madh të institucioneve financiare, megjithëse pjesëmarrja e tyre në gjithësej asetet e sistemit financiar vazhdon të qëndroj në 0.2 përqind (grafik 17).


Grafik 17. Pjesëmarrja në gjithësej asetet e sistemit financiar



Kapitali i huaj mbizotëron pjesën më të madhe të sektorëve të sistemit financiar, e veçanërisht sektorëve që merren me aktivitet kredites (grafik 18).

Sektori bankar dominohet nga kapitali me prejardhje nga BE, që përbën 56.9 përqind të gjithëj aseteve të sektorit. Bankat vendore kishin prezencë të ngjashme me vitin e kaluar në tregun bankar (prej 13.3 përqind). Bankat me origjinë nga Turqia shënuan rënie të lehtë të pjesëmarrjes në treg, me një pjesëmarrje prej 16.5 përqind në vitin 2019 (17.5 përqind në vitin 2018).

Grafik 18. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2019




Burimi: BQK (2020)

Zhvillime të tilla kanë kontribuar në rritjen e konkurrencës së shërbimeve dhe në uljen e koncentrimin bankar. Shkalla e koncentrimin bankar¹⁷ zbriti në 56.9 përqind nga 57.3 përqind në vitin e kaluar. Sektori i sigurimeve vazhdon të ketë nivel më të ulët të koncentrimin si rrjedhojë e shpërndarjes më të barazpeshuar të aseteve në treg. Mirëpo, krahasuar me vitin e kaluar, të dhënat tregojnë se është shënuar rritje e lehtë e koncentrimin si rrjedhojë e revokimit të licencës të njëjës nga kompanitë e sigurimit gjatë vitit 2019.

Kompanitë e sigurimit me kapital vendor përbëjnë 49.9 përqind të gjithëj aseteve, nga 47.7 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, kompanitë me kapital të huaj kanë vend të origjinës Austrinë, Slloveninë dhe Shqipërinë (grafik 18).

Sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë, përkitazi me modelin tradicional të aktiviteteve, me ndërlidhje minimale të aktiviteteve ndërmjet sektorëve të sistemit.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2020)

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion, përjashtuar Qeverinë Qendrore ku është marrë për bazë gjithëj detyrimet që i ka në formë të letrave me vlerë ndaj këtyre institucioneve. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2019.

Ndërlidhjet mes akterëve të sektorit nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në vitin 2019. Lidhjet kryesore qëndrojnë në formë të depozitave në BQK dhe banka komerciale (figura 1). Megjithatë, niveli i këtyre ndërlidhjeve është i ulët, duke minimizuar kështu mundësitë e bartjes së problemeve dhe rreziqeve nga një institucion në tjetrin.


Ndërlidhja më e theksuar qëndron në mes të bankave komerciale dhe BQK-së, që përfaqësohet në formë të depozitave për rezervën e detyrueshme që bankat duhet mbajtur në BQK.

Kompanitë e sigurimeve dhe fondet pensionale po ashtu mbajnë kërkesa, në formë të depozitave të transferueshme (llogarive rrjedhëse) ndaj BQK-së, e që së bashku me bankat komerciale në dhjetor 2019 përbënin 35.0 përqind të gjithëj depozitave të BQK-së. Depozitat që institucionet financiare jo-bankare mbajnë në banka komerciale paraqesin ekspozim të konsiderueshëm ndër-institucional (përjashtuar ekspozimin ndaj qeverisë) për disa nga këto institucione. Kompanitë e sigurimeve mbajnë si depozita në

¹⁷ Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithëj aseteve të sektorit

banka komerciale rreth 46.8 përqind të aseteve të tyre. Ndhmësit financiar, në dhjetor 2019, rritën pjesëmarrjen e bilancit me bankat komerciale në gjithsej asetet e tyre në 45.3 përqind nga 29.3 përqind vitin paraprak. Ndërsa, fondet pensionale dhe mikrofinancat kishin 9.4 përqind dhe 4.7 përqind, respektivisht, të aseteve të tyre si depozita në banka komerciale. Pra, depozitat e këtyre institucioneve konsistojnë 7.8 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar. Rrjedhimisht, rëndësia e sektorit bankar në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar është e pa kontestueshme dhe likuiditeti i sektorit bankar paraqet faktor me rëndësi në funksionimin stabil të këtyre institucioneve, pasi që në kontekst të ndërlidhjeve, depozitat përbëjnë kanalin kryesor për bartje të mundshme të problemeve ndër-institucionale. Ndërsa, kërkesat e bankave komerciale ndaj institucioneve të tjera financiare jo-bankare, që përfaqësohen në formë të kredive, përbëjnë rol minor në ndërlidhjet financiare marrë parasysh që këto kredi përbëjnë vetëm 0.2 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK (2020)

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion bankar, përjashtuar bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia vizë-lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2019.

Në figurën e ndërlidhjes është përfshirë edhe ekspozimi i sistemit financiar ndaj Qeverisë Qendrore, i shprehur në formë të letrave me

vlerë, pasi që është konsideruar se rëndësia e ekspozimeve të tilla është në rritje në kushtet kur mundësitë për investime nga ana e institucioneve janë të kufizuara pikërisht në letra me vlerë qeveritare dhe depozita-kredi. BQK është investuesi kryesor në letrat me vlerë të qeverisë, pasuar nga fondet pensionale dhe bankat komerciale. Institucionet e tjera financiare gjithashtu kanë kërkesa ndaj Qeverisë në formë të letrave me vlerë qeveritare, ndërsa, Qeveria ka kërkesa (ekspozim) vetëm ndaj BQK-së dhe bankave komerciale përmes depozitave që mban në këto institucione.

Lidhjet ndërbankare janë akoma më të koncentruara se sa ato ndër-institucionale, ku disa banka që janë relativisht më të vogla kanë ekspozime të theksuara ndërmjet tyre brenda sistemit financiar në vend (figura 2). Bankat e mëdha ekspozimet kryesore i kanë në tregjet e jashtme, ndaj bankave amë apo edhe bankave e institucioneve të tjera financiare. Lidhjet e theksuara ndërmjet katër bankave në vend të paraqitura në grafën më lartë, përfaqësohen kryesisht në formë të burimeve të financimit siç janë depozitat. Lidhja më e theksuar paraqitet në mes të bankës H me dy bankat I dhe D, për shkak të kërkesave financiare në formë të depozitave të afatizuara që banka H ka ndaj këtyre dy bankave (që njëkohësisht janë burime financimi për këto të fundit, bankat I dhe D). Banka C gjithashtu ka ndërlidhje më të theksuar me bankat I dhe D, në formë të kërkesave ndaj tyre. Ndaj bankës D, banka C ka edhe detyrime, por që janë pothuajse përgjysmë më të ulëta se kërkesat ndaj saj. Ndërlidhjet me bankat amë përkatëse janë më të theksuarat tek bankat F, G dhe D, kryesisht në formë të detyrimeve në formë të linjave kreditore të huazuara në tregun e parasë ndërbankare si dhe borxhit të ndërvarur. Banka E ka gjithashtu ndërlidhje të theksuar me bankën amë, por në formë të kërkesave ndaj saj, përkatësisht depozitave në bankën amë dhe degët e tjera të grupit.


4.1. Aktiviteti bankar

Veprimtaria e sektorit bankar gjatë vitit 2019 u karakterizua me rritje të aktivitetit, mbështetur kryesisht nga

rritja e kreditimit dhe investimeve në tregun e letrave me vlerë. Asetet e sektorit bankar u rritën për 13.7 përqind nga viti paraprak, dhe arritën vlerën prej 4.76 miliardë euro. Rritja i atribuohet kryesisht dinamikave pozitive me të cilat u karakterizua aktiviteti kreditor, i cili vazhdon të mbështetet kryesisht nga depozitat.

Në kuadër të aseteve, me rritje të lartë vjetore u karakterizua kategoria e bilancit me bankat komerciale (rritje vjetore prej 29.3 përqind) dhe kategoria e parasë së gatshme dhe rezervave të mbajtura në BQK (rritje vjetore prej 14.9 përqind). Rritja në kuadër të kategorisë së bilancit me bankat komerciale erdhi si rezultat i plasimit të mjeteve në sektorin e jashtëm në formë të depozitave të afatizuara dhe atyre të transferueshme. Në anën tjetër, përkundër vazhdimit të normës negative të interesit të aplikuar nga BQK mbi tepriçën e rezervës obligative që bankat komerciale mbajnë në BQK, kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 20.8 përqind. Kjo rritje reflekton nivelin e lartë të depozitave të arkëtuara gjatë vitit 2019, por njëkohësisht edhe mundësitë e ulëta për investim/plasim të mjeteve.


Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve



Sektori nuk ka pësuar ndryshime strukturore në anën e aseteve ndër vite, me përjashtim të nënkategorisë së letrave me vlerë që shënoi rritje nga viti 2012 si rezultat i fillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjes aktive të bankave në këtë treg (grafik 19). Stoku i letrave me vlerë shënoi rritje vjetore prej 22.4 përqind, ndikuar deri në një masë nga rritja e investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja. Megjithatë, investimet në letrat me vlerë të qeverisë së

Kosovës, për të dytin vit me radhë, kishin pjesëmarrjen më të lartë në këtë instrument (54.6 përqind, përkatësisht 59.8 përqind në vitin paraprak).

Grafik 20. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të finanohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, të cilat këtë vit shënuan rritje të theksuar krahas një viti më parë.

Aktiviteti i sektorit bankar mbështetet nga depozitat në nivelin prej 82.1 përqind (grafik 20). Gjithsej depozitat u rritën për 16.2 përqind dhe arritën nivelin prej 3.91 miliardë euro, ndikuar kryesisht nga depozitat e transferueshme të ekonomive familjare.

Depozitat e ekonomive familjare, që përbëjnë 66.6 përqind të gjithsej stokut të depozitave, shënuan rritje prej 11.5 përqind (grafik 21). Në rritjen e depozitave të ekonomive familjare rol të rëndësishëm kanë remitencat, niveli i të cilave vazhdoi që të rritet edhe gjatë vitit 2019. Ndikim i tyre në sektorin bankar është më i lartë në dy tremujorët e fundit të vitit, si rezultat i sezonit veror dhe festave të fundvitit, kur fluksi i emigrantëve që vizitojnë vendin rritet. Ky efekt i remitencave në nivelin e depozitave të arkëtuara nga ekonomitë familjare pritet të vërehet edhe në vitin vijues, pasi që përhapja e pandemisë Covid-19 do të ndikoj negativisht në ardhjen e bashkatdhetarëve në vend në sezonin e verës dhe festave të fundvitit.

Grafik 21. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2020)

Ky vit u karakterizua me rritje më të theksuar të depozitave nga sektori financiar dhe ai jofinanciar. Në kuadër të sektorit financiar, kompanitë e sigurimeve rritën nivelin e depozitave (të afatizuara) të mbajtura në bankat vendore, me qëllim të përmirësimit të nivelit të likuiditetit të sektorit (parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike apo dhe detyrimeve). Po ashtu, edhe Fondet Pensionale rritën nivelin e depozitave (të afatizuara) në sektorin bankar, por në vlerë më të ulët krahasuar me periudhën paraprake. Depozitat e arkëtuara nga korporatat jofinanciare shënuan rritjen më të theksuar krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje e depozitave mund të ketë ardhur si rezultat i transferimit të fondeve apo donacioneve të fituara prej investitorëve të jashtëm dhe të brendshëm në llogaritë bankare të bizneseve dhe furnitorëve të tyre, për të investuar në projekte të destinuar për të zhvilluar sektorë të caktuar të ekonomisë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të jetë i ulët, por që shënoi rritje të theksuar krahasuar me vitin 2018. Pozicioni neto kreditor ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje të konsiderueshme, për 49.1 përqind, duke arritur vlerën në 431.6 milionë euro (grafik 22 dhe 28). Kjo rritje e theksuar e pozicionit neto kreditor ishte kryesisht rrjedhojë e investimeve në sektorin e jashtëm, në formë të depozitave dhe letrave me vlerë.


Grafik 22. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve



Burimi: BQK (2020)

Kërkesat ndaj jorezidentëve zënë 13.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ku 91.7 përqind e tyre janë depozita dhe investime në letra me vlerë.

Grafik 23. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK (2020)

Detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve zënë 4.8 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar, në formë të linjave kreditore dhe depozitave të sektorit të jashtëm të mbajtur në vend. Kreditë e marra nga sektori i jashtëm dhe depozitat e sektorit të jashtëm të mbajtura në vend, së bashku përbëjnë 99.2 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj jorezidentëve.


Megjithë rritjen në periudhën e fundit, në përgjithësi, sektori bankar ka ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Niveli i ulët i aseteve në valutë të huaj zvogëlon më tej efektet e bartjes së problemeve nga sektori i jashtëm si dhe eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet jo të favorshme në kurset e këmbimit kundrejt valutës euro.

4.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar vazhdoi trendin e rritjes dy shifrore për të katërtin vit me radhë. Megjithatë, për vitin 2020 pritjet janë që ky trend i rritjes së kreditimit të ndërpritet, si pasojë e ndryshimit të dinamikave të ekonomisë së brendshme dhe atë të jashtme, në përballje me përhapjen pandemisë Covid-19.

Dinamika e aktivitetit kreditues për korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht gjatë vitit 2019 si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi. Përmirësimi i ofertës kreditore nga bankat, kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit në kredi dhe zgjatjes së maturitetit të kredive kontribuoi në rritjen e kreditimit.

Grafik 24. Rritja vjetore e kredive ndaj korporatave jofinanciare dhe ekonomitë familjare




Faktorë tjerë me ndikim në dinamikat e kreditimit ishin përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor, likuiditeti i mjaftueshëm dhe konkurrenca bankare, që luajtën rol kyç në zgjerimin e aktivitetit kreditor të bankave në këto katër vitet e fundit. Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 3.03 miliardë euro, që paraqet rritje prej 10.0 përqind, mbështetur kryesisht nga kreditë ndaj korporatave jofinanciare (grafik 24).

Kreditë për korporatat jofinanciare shënuan rritje prej 9.8 përqind dhe arritën vlerën prej 1.92 miliardë euro. Ndërsa, kreditë e reja për korporatat jofinanciare u shtuan për 895.8 milionë euro (grafik 25), nga të cilat për qëllime investuese për 524.2 milionë euro,

ndërsa kreditë për qëllime jo-investuese për 355.6 milionë euro.

Grafik 25. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të ndaj korporatave jofinanciare dhe ekonomitë familjare, në milionë euro




Kreditimi bankar është rritur ndaj pothuajse të gjithë sektorëve ekonomik, me përjashtim të sektorit të tregtisë që shënoi rënie marginale. Sektorët që u kredituan më shumë në vitin 2019 ishin prodhimtaria, minierat, ndërtimtaria dhe shërbimet financiare.

Kreditë për sektorin e prodhimit dhe atë të ndërtimit u rritën për 19.9 përqind dhe 8.7 përqind, duke arritur vlerën prej 261.5 dhe 170.3 milionë euro, respektivisht. Megjithatë, pjesëmarrja e këtyre sektorëve në gjithsej portofolin kreditor mbetet relativisht e ulët.

Sektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e gjithsej kredive, shënoi rënie vjetore prej 0.5 përqind (grafik 26). Ndërsa, me rënie prej 30.6 përqind u karakterizua edhe sektori i energjetikës, megjithëse pjesëmarrja në gjithsej stokun e kredive konsiston të jetë 2.3 përqind.

Mbështetës i rëndësishëm i kreditimit ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2019 ishte edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, arriti në 4,052 në fund të vitit 2019 (2,262 në fund të vitit 2018). Shuma totale e kredive të garantuara në vitin 2019 shënoi 156.3 milionë euro, një numër pothuajse i dyfishuar kundrejt vlerës së garantuar prej 87.2 milionë euro në vitin paraprak (grafik 27).


Grafik 26. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK (2020)

Struktura e kredive të garantuara është përfaqësimit i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç'rast dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësimit prej 10.0 përqind në gjithsej portofolin e kredive të garantuara, që paraqet rritje të peshës krahas përfaqësimit prej 7.0 përqind në vitin paraprak. Prospektet pozitive të rritjes së vlerës së FKGK-së dhe fokusimit në mbështetjen e sektorëve specifikë me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritet të reflektohen në rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi dhe sektorë të caktuar në veçanti. Po ashtu, edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, pas shfaqjes së krizës ekonomike dhe shëndetësore të prodhuar si rezultat i përhapjes së pandemisë Covid-19, FKGK-ja ka vazhduar të mbështesë NVM-të përmes garancive kreditore. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, kapitali garantues i FKGK-së është rritur për 6.5 milionë euro për agrobiznese, si rezultat i marrëveshjes financiare mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj Gjermane. Kjo do të ndikojë në rritjen e qasjes në financa nga bizneset (rritje të likuiditetit për të operuar), që është mëse e nevojshme në këtë periudhë krize shkaktuar nga Covid-19.

Grafik 27. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK



Burimi: FKGK (2020)

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj ekonomive familjare është rritur në vazhdimësi, por trendi i rritjes dyshifrore të kredive të reja, në veçanti atyre konsumuese, ndërroi kahje këtë vit.

Niveli i ulët i ngarkesës me borxh të klientëve (bazuar në indikatorin raporti borxh ndaj të ardhurave), cilësia e lartë e klasifikimit kreditor të ekonomive familjare, dhe oferta më e mirë bankare janë ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e përsheptuar të kreditimit për këtë segment në vitet e fundit. Deri në dhjetor të vitit 2019, vlera e kredive të destinuara për ekonomitë familjare arriti në 1.10 miliardë euro, apo për 10.4 përqind më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, ritmi i rritjes së kreditimit për këtë segment rezulton të jetë ngadalësuar, dinamikë që i atribuohet rënies së kredive të reja konsumuese për 4.1 përqind, kategori kjo që ka një pjesëmarrje të lartë prej 71.7 përqind të kredisë së re për ekonomitë familjare (grafik 25).


Në grafikun 28 jepen informacione për stokun e kredive të lëshuara nga sektori bankar deri në dhjetor 2019, të ndara në persona fizik dhe juridik. Këto të dhëna nuk publikohen në seri kohore, por kanë për burim regjistrin e kredive. i referohen periudhës së fundit dhe këtu ofrojnë gjendjen statike, duke mos paraqitur ecurinë e zhvillimit.¹⁸

Pjesa më e madhe e kredive (rreth 80.6 përqind) karakterizohen si hua, ndërsa kreditë konsumuese dhe hipotekare kanë një pjesëmarrje

¹⁸ Kreditë konsumuese për persona juridik mund të përfshijnë linja kreditore që janë të kategorizuara si mbiltërheqe dhe hyjnë në kuadër të kredive konsumuese.

rreth 14.1 përkatësisht 2.2 përqind. Megjithatë, sa i përket kategorizimit të kredive, duhet pasur parasysh që kategoria hua mund të përfshijë edhe kategori tjera të kredive.¹⁹

Grafik 28. Kredimarrësit fizik dhe juridik sipas llojit dhe klasifikimit kreditor, dhjetor 2020




Burimi: BQK, Regjistri i Kredive (2020)

Varësisht nga politikat kreditore të bankave apo ofertave promocionale, këto kredi mund të lëshohen pa kolateral dhe garantues, e si pasojë e kufizimeve rregullative.²⁰ Sa i përket peshës, 31.1 përqind e stokut të kredive rezultojnë të jenë hua të destinuara për persona fizik, ndërsa 49.5 përqind janë hua për persona juridik. Kreditë hipotekare për persona fizik përbëjnë rreth 1.9 përqind të gjithsej kredive, përdërisa për persona juridik 0.3 përqind. Ndërsa, kreditë konsumuese për persona fizik ndajnë rreth 3.9 përqind të pjesëmarrjes krahasuar me persona juridik që kanë pjesëmarrje prej 10.2 përqind. Megjithatë, kreditë konsumuese (ku përfshihen kredit kartelat dhe mbitërheqjet), për persona juridik duhet analizuar me kujdes duke qenë se për dallim nga personat fizik që shfrytëzojnë këtë lloj kredie kryesisht për qëllime konsumuese, personat juridik mund të shfrytëzojnë këto kredi për qëllime komerciale. Pothuajse të gjitha llojet e kredive kanë mbi 90.0 përqind klasifikim kreditor A (apo standard). Për persona juridik, 93.1 përqind e kredive të kategorizuara si hua kanë klasifikim kreditor A, ndërsa për persona fizik, 97.4 përqind të kredive 'hua' rezultojnë të jenë me klasifikim kreditor A.

¹⁹ Kreditë hua për persona fizik mund të përfshijnë linja kreditore të cilat janë të lëshuara për qëllime hipotekare, ndërtim dhe renovim, nëse nuk i plotësojnë kushtet dhe rregullat që të klasifikohen në kategorinë 'kredi hipotekare'.


Grafik 29. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: korporatat jofinanciare



Burimi: BQK (2020)

Kreditë me maturitet afatgjatë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej kredive me pjesëmarrje prej 47.0 përqind,²¹ shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 14.9 përqind.

Grafik 30. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2020)

Vlera e tyre arriti në 1.42 miliardë euro. Kreditë me maturitet afatmesëm u rritën për 9.5 përqind dhe arritën vlerën në 1.25 miliardë euro. Kreditë me afat të mesëm maturiteti janë kryesisht të dominuara nga kreditë e lëshuara për korporatat jofinanciare, përdërisa kreditimi afatgjatë është kryesisht karakteristikë e portofolios kreditore të segmentit të ekonomive familjare (grafik 30). Sipas Anketës së Kreditimit Bankar (kutia 3), orientimi i ekonomive familjare drejtë kredive afatgjata i atribuohet lehtësimit të kushteve të kreditimit nga bankat për këtë segment, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive ku bankat zvogëluan kërkesat për kolateral, rritën shumën e aprovuar dhe zvogëluan normat mesatare të interesit.

²⁰ Neni 6 i Rregullores për Kredi Hipotekare Rezidenciale përcakton qëllimet dhe kushtet në bazë të të cilave kredia lëshohet dhe kategorizohet si kredi hipotekare rezidenciale.

²¹ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjate përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

Anketa e Kreditimit Bankar²²

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar²³ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës tetor - dhjetor 2019 (referuar si TM4 2019)²⁴, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën janar - mars 2020 (referuar si TM1 2020).

Shënim: Kjo anketë u realizua gjatë muajit Janar 2020, kur, epidemia nga virusi COVID-19 nuk kishte marrë ende përmasa globale dhe të shndërrohej në pandemi. Rrjedhimisht, efektet e këtij virusi, tashmë të shpallur si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, nuk u reflektuan në pritjet e bankave për dinamikën e kreditimit gjatë tremujorit të parë të vitit 2020.

Pasiguritë e krijuara në realizimin e të ardhurave si nga ekonomitë familjare ashtu edhe nga ndërmarrjet, si pasojë e masave të ndërmarra për mospërhapjen e virusit, potencialisht do të reflektohen në ofertën kreditore nga sektori bankar si dhe në kërkesën për kredi nga subjektet ekonomike. Megjithatë, materializimi dhe shkalla e vështirësive të bankave si pasojë e rreziqeve të mundshme varen nga kohëzgjatja e krizës, gjendja në


sektorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe masat që institucionet relevante do t'i ndërmarrin në mbështetjen e sistemit financiar dhe ekonominë e vendit në përgjithësi.

Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë TM4 2019, sipas anketës së kreditimit bankar, rezultoi të jetë ndikuar pozitivisht si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha mbetën kryesisht të pandryshuara, përderisa për NVM-të, standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë.

Për tremujorin e parë të vitit 2020, bankat pritjet t'i mbajnë standardet kreditore pothuajse të pandryshuara për NVM-të dhe lehtësim marginal për ndërmarrjet e mëdha (grafik 31).

Grafik 31. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2020)

Faktorët kryesor që ndikuan në lehtësimin e standardeve kreditore, sipas deklaratimit të

bankave, ishin mbështetja e ndërmarrjeve nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)

²² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës 9 banka që operojnë në Kosovë dhe përfaqësojnë 99.9 përqind të kreditimit të gjithësej sektorit. Anketa realizohet në baza tremujore. Kjo anketë përfshinë periudhën tetor - dhjetor 2019 dhe pritjet për periudhën janar - mars 2020.

²³ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithësej portfolion kreditore të sektorit bankar.

Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në web faqen e BQK.

²⁴ Periudhës tetor - dhjetor i referohemi si 'tremujori i katërt' – TM4, ndërsa periudhës janar - mars i referohemi si 'tremujori i parë' – TM1.


dhe presionet e rritura të konkurrencës ndërmjet bankave në vend. Në të njëjtën periudhë, një nga bankat me peshë të madhe në sektorin bankar deklaroi se ndikim pozitiv në lehtësim të standardeve kreditore kishte financimi nga banka amë.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan në një masë të përafërt me tremujorin paraprak. Presioni i konkurrencës nga bankat tjera si dhe mbështetja nga FKGK ndikuan në zbutjen e kushteve të kreditimit deri në një masë. Konkretisht, lehtësim më të madh kishte në normat e interesit dhe kërkesave për kolateral, ku të njëjtat në tremujorin paraprak ishin

pothuajse të pandryshuara. Këto ndryshime, i atribuohen në masë me të madhe kushteve dhe rregullave për NVM-të. Ndërsa në një masë të vogël, bankat rritën edhe maturitetin për kreditë e aprovuara për ndërmarrjet e mëdha (grafik 32).

Bankat presin që gjatë tremujorit të ardhshëm të lehtësojnë në masë më të ulët kushtet dhe rregullat për kreditë e reja krahasuar me këtë tremujor. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që do të ofrojnë norma më të ulëta të interesit edhe pse në një nivel më të ulët në krahasim me TM4 2019, lehtësime në madhësinë e kredive të aprovuara dhe kërkesa më të favorshme për kolateral. Lehtësimet e lartpërmendura do të mbështesin në një nivel më të lartë NVM-të.

Grafik 32. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2020)


Gjatë periudhës raportuese, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi të jetë rritur, megjithëse në anketën e kaluar, bankat kishin raportuar pritje për rritje më të lartë të kërkesës nga segmenti i ndërmarrjeve. Rritja e kërkesës për ndërmarrjet ishte e ngjashme si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha (grafik 33). Për më tepër, përmirësim në cilësinë e aplikacioneve të pranuar kishte marginalisht në ato të NVM-ve, përderisa cilësia e aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet e mëdha mbeti pothuajse e pandryshuar. Gjithashtu, bankat deklaruan vazhdimin e trendit rënës të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet.

Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet në masë më të madhe u ndikua

nga kërkesa për ristrukturim të borxhit, e shprehur nga vetëm dy banka mirëpo me peshë të madhe në sektor. Njëkohësisht, ndërmarrjet rritën kërkesën deri në një masë për financim të inventarëve dhe kapitalit punues. Kërkesa për blerje, bashkim apo ristrukturim të ndërmarrjeve u karakterizua me një indeks të ulët pozitiv, duke paraqitur situatën në dy banka.

Në tremujorin vijues, bankat presin aktivitet më të madh të ndërmarrjeve, duke e pasqyruar këtë në parashikimet e tyre për ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë TM1 2020. Kërkesë dukshëm e rritur pritet si nga NVM-të ashtu edhe nga ndërmarrjet e mëdha. Kërkesa e rritur për kredi pritet të ndikohet nga nevoja e ndërmarrjeve për financimin e investimeve fikse si dhe inventarëve dhe kapitalit punues.

Grafik 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK (2020)

Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se kërkesë më të madhe gjatë kësaj periudhe kishte për kreditë afatshkurtra, gjithashtu edhe kërkesa për kredi afatgjata u rrit mirëpo në një shkallë më të vogël. Përderisa, oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive favorizoj po ashtu kreditë afatshkurtra. Në tremujorin e ardhshëm, bankat nuk presin lëvizje domethënëse të standardeve kreditore në të dy afatet kohore. Përderisa, bankat presin rritje të theksuar të kërkesës për kredi me maturitet afatgjatë. Njëkohësisht, edhe kërkesa për kredi afatshkurtra pritet të ketë rritje mirëpo në një nivel më të ulët (grafik 34).

Dinamikat e aktivitetit kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan pozitivisht si nga oferta e favorshme kreditore ashtu edhe nga kërkesa e ekonomive familjare për kredi. Standardet kreditore të aplikuara gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan, në veçanti për kreditë konsumuese (grafik 34).

Pritjet e bankave për TM1 2020 japin indikacione për vazhdimësinë në lehtësimin më të lartë të standardeve kreditore për kreditë konsumuese, përderisa për segmentin e kredive për blerjen e shtëpive nuk presin ndryshime të dukshme.

Grafik 34. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2020)


Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare në përgjithësi u lehtësuan në tremujorin e katërt të vitit 2019. Lehtësim në një masë më të madhe kishin kreditë e reja konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë konsumuese u lehtësuan përmes

rënies së normave të interesit, rritjes së shumës së aprovuar dhe uljes së kërkesave për kolateral. Ngjashëm, kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive u mbështetën përmes ofrimit të normave më të favorshme të interesit (indeks pozitiv prej 0.26), rritjes së

shumës së kredive të aprovuara (indeks pozitiv prej 0.18) si dhe në një masë më të vogël kërkesave më të ulëta për kolateral (indeks pozitiv prej 0.13) (grafik 35). Rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, cilësia e lartë e portfolios kreditore, si dhe në një masë më të vogël toleranca e rritur

për rrezik përkrah perspektivës së favorshme të tregut bankar në vend, rezultojnë të kenë qenë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019.

Grafik 35. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK (2020)

Në tremujorin e ardhshëm pritet lehtësim i mëtutjeshëm i kushteve dhe rregullave, të ndikuar pozitivisht nga rreziku më i ulët i perceptuar nga ana e bankave, rritja e konkurrencës në mes të bankave në vend dhe

përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore. Bankat pritet të ofrojnë kushte dhe rregulla të ngjashme si për kreditë konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerjen e shtëpive.

Grafik 36. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK (2020)

Bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare. Të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare kishin rritje të kërkesës, mirëpo kërkesa për kredi konsumuese ishte më të lartë se sa kërkesa për kreditë për blerjen e shtëpive (grafik 36). Rritja e kërkesës nga ekonomitë familjare për kreditë konsumuese kryesisht i atribuohet rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve për aftësitë e tyre për kthim të kredisë. Përderisa, përderisa financimi i konsumit dhe kërkesat për ristrukturim të

borxhit gjatë këtij tremujori dhanë kontribut negativ në rritjen e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare. Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese deri në një masë, rezultojnë të jetë përmirësuar.

Bankat presin edhe më tutje rritje të kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm, mirëpo për dallim me TM 4 2019 pritet që kërkesa për kreditë për blerje të shtëpive të ketë rritje më të lartë se sa kërkesa për kredi konsumuese.

Grafik 37. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit



Burimi: BQK (2020)


Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se ekonomitë familjare gjatë kësaj periudhe kishin kërkesë më të lartë deri në një masë për kreditë afatgjata kundrejt atyre me afat më të shkurtër të maturitetit.

Oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive rezulton të jetë e koncentruar në lehtësime deri në një masë për kreditë afatshkurtra dhe pothuajse e pa ndryshueshme për kreditë afatgjata.

Për dallim nga TM4 2019, bankat presin që në tremujorin e ardhshëm, lehtësimi në ofertën kreditore do të orientohet në nivel më të lartë drejt kredive afatgjata, se sa në kreditë afatshkurtra. Kërkesa për kreditë pritet të ketë rritje të ngjashme për të dy afatet e maturitetit (grafik 37).

Bankat deklaruan për rritje të kënaqshme të gjithsej financimit në periudhën raportuese.

Grafik 38. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK (2020)


Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve. Rezultatet tregojnë që financimi i bankave u rrit dukshëm nga depozitat e ndërmarrjeve. Dy nga bankat deklaruan rritje të financimit edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Sipas maturitetit, në këtë tremujor indeksi ishte i përafërt për depozitat afatshkurtra dhe ato afatgjata. Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin rritje të qasjes në financim, megjithëse në intensitet dukshëm më të ulët. Financimi

përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ketë rritje, ndërsa financimi nga ana e depozitave të ndërmarrjeve pritet të ketë rënie deri në një masë në krahasim me tremujorin paraprak. Për dallim nga tremujori i katërt 2019, në tremujorin e ardhshëm nuk pritet mbështetje në financim të aktivitetit të bankave në vend nga institucionet financiare ndërkombëtare. Për më tepër, në tremujorin vijues anketat sinjalizojnë pritjet për rritjen e financimit afatgjatë, përderisa financimi afatshkurtër pritet të jetë i pandryshueshëm (grafik 38).

5. Rreziqet e sektorit bankar

Sektorit bankar përgjatë gjithë vitit 2019 ka operuar në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve ndaj të cilave mund të përballet dhe kapacitet të kënaqshëm të përbalimit të goditjeve të mundshme. Me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit, është ndërtuar indeksi i stabilitetit të sektorit bankar. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar është ndërtuar me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas. Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.²⁵

Grafik 39. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar




Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, sektori bankar në mesatare ka shënuar rritje vit-më-vit të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (rënie të indeksit) (grafik 39). Krahasuar me vitin e kaluar, rënie të indeksit (lexo: rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut), shënuan indikatorit i solvencës, rrezikut të tregut dhe profitabilitetit. Ndërsa, rritje të indeksit (ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënoi

²⁵ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

indikatorit i rrezikut kreditor. Ndikim neutral në kalkulimin e indeksit të përgjithshëm, kishte indikatorit i rrezikut të likuiditetit.

Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor kryesisht i atribuohet nivelit të ulët të kredive me probleme, si dhe trendit rënës të vlerës së këtyre kredive (që nga tremujori i katërt i vitit 2014) (grafik 40). **Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës** i atribuohet uljes së nivelit të kapitalizimit, por që gjithsesi është dukshëm në nivel më të lartë se sa minimumi i kërkuar me rregullore të BQK-së. Në rënie të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e aseteve që bartin rrezik krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të kapitalit rregullativ. Rritja më e shpejtë e aseteve të peshuara me rrezik është ndikuar nga rritja e përsheptuar e kreditimit në vitet e fundit. Kurse, ngadalësimi i rritjes së kapitalit erdhi si rezultat i ndarjes së dividendave gjatë vitit 2019. **Rritja ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit** kryesisht i atribuohet profitit më të ulët të realizuar nga bankat, që vjen si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt të hyrave.

Grafik 40. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kritereve të rreziqeve



Indikatorit që mat **ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak të nivelit të ulët të aseteve dhe detyrimeve janë në valutë të huaj kundrejt gjithsej aseteve, respektivisht detyrimeve të sektorit bankar. Po ashtu, edhe niveli i kredive**

dhe depozitave në valutë të huaj është mjaftë i ulët. Si rrjedhojë, lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaftë të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar. Në këtë indikator, të matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, në fund të dhjetorit 2019, është shënuar rritje (në 5.1 përqind, nga 1.3 përqind në vitin e kaluar).

Ndikim neutral të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, kishte indikatorin e rrezikut të likuiditetit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Kjo, pasi që niveli i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, respektivisht gjithsej aseteve ishin në nivele të përafërta me periudhën paraprahe.

Edhe pse indeksi i përgjithshëm i agreguar ka shënuar rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, ai qëndron lehtësisht mbi mesataren historike të indeksit (2008-2019). Ky është një indikator shtesë që lënë të nënkupton që sektori bankar është i qëndrueshëm dhe mund të përballoj rreziqet prej të cilave është i ekspozuar.

Tabela 5. Rreziqet e sektorit bankar


Rreziqet	Indikatorët	2015	2016	2017	2018	2019	Kahja e rrezikut	Interpretimet
Rreziku Kreditor	Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive (%)	6.2%	4.9%	3.1%	2.7%	2.0%	↓	Rreziku kreditor u zvogëlua edhe më tutje, si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit krahas rënies së kredive joperformuese. Përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditorë u ndikua edhe nga procesi i shlyerjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave. Po ashtu, rënia e stokut të KJP-ve ka ndikuar në rritjen e raportit të mbulueshmërisë me provizione.
	Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione (%)	115.1%	127.6%	149.7%	152.1%	163.5%		Përqëndrimi i ekspozimeve të mëdha kreditorë është rritur, por qëndron nën nivelin maksimal rregullator 300%. Rritja erdhi si rezultat i rritjes së ekspozimeve kryesisht nga bankat e mëdha, me rëndësi sistematike.
	Ekspozimet e mëdha kreditorë/Kapitalit i Klasit të parë (%)	67.3%	69.5%	88.9%	68.7%	81.8%		
Rreziku i Profitabilitetit	Të hyrat neto nga interesi (në milion euro)	163.3	160.3	159.7	171.0	179.4	↑	Të hyrat neto nga interesi u rritën, si rezultat i rritjes së kreditimit. Por, rritja më e lartë e shpenzimeve, kryesisht atyre të interesit për depozita, ndikuan në rënie vjetore të profitit. Të gjitha kategoritë e tjera të shpenzimeve shënuan rritje, duke ngritur raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave.
	Të hyrat neto nga jo-interesi (në milion euro)	47.5	17.7	41.7	32.6	23.3		
	Shpenzimet/Të hyrat	60.3%	67.3%	64.6%	65.1%	67.2%		
	Kthimi Mesatar në Kapital (ROE)	29.1%	19.7%	21.3%	20.4%	18.9%		
Rreziku i Tregut	Hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit (në milion euro)	1,740	1,538	1,735	1,684	1,871	→	Hendeku kumulativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit është zgjeruar, por mospërputhjet u ngushtuan në pothuajse të gjitha afatet e maturimit përveç atij të '90-365' ditë. Ngushtimi i mospërputhjeve erdhi si rezultat i rritjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi dhe borxhit të ndërruar, si dhe rritjes së kredive më afatshkurtëra.
	Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë (%)	1.9%	4.6%	1.2%	1.3%	5.0%		Pozicioni i agreguar neto i hapur në valuta të huaja u rrit gjatë vitit, duke rritur deri në një masë ekspozimin, edhe pse qëndron larg nga minimuni rregullator.
Rreziku i Solvencës	Kapitali rregullator/Asetet me peshë rreziku (%)	19.0%	17.8%	18.1%	17.0%	15.8%	↑	Raporti i kapitalit rregullator shënoi rënie si rezultat i rritjes më të lartë të asetëve të peshuara me rrezik, të ndikuar nga rritja e kreditimit. Rënia u ndikua nga rritja e asetëve të peshuara me rrezik, por edhe rënia e nivelit të kapitalit rregullator nga tri nga bankat më të mëdha, me rëndësi sistematike.
	Kapitali i Klasit të parë/Asetet me peshë rreziku (%)	16.6%	15.8%	16.2%	15.5%	14.1%		
	Ekuiteti/Asete	11.7%	12.1%	12.6%	12.3%	11.2%		
Rreziku i Likuiditetit	Raporti kredi/depozita (%)	74.7%	77.0%	80.3%	81.9%	77.6%	→	Indikatorët e likuiditetit tregojnë për pozitë të mirë financiare të sektorit bankar si dhe për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditues. Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra u zvogëlua lehtësisht si rezultat i rritjes më të lartë të detyrimeve afatshkurta se sa rritja e asetëve likuide.
	Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra (%)	44.9%	41.5%	37.9%	38.5%	37.6%		
	Hendeku i Likuiditetit (në milion euro)	398.1	405.1	463.8	494.4	513.6		
			Rrezik në rritje	Rrezik në rënie	Rrezik i pandryshueshëm			

Burimi: BQK (2020)

5.1. Rreziku kreditor

Cilësia e portfolios kreditore në nivel të sektorit bankar ka vazhduar përmirësimin në vitin 2019, e mbështetur nga rënia e kredive jo performuese kryesisht të segmentit të ndërmarrjeve. Norma e kredive joperformuese zbriti në nivelin më të ulët historik, në 2.0 përqind.

Grafik 41. Rritja vjetore e kredive dhe kredive joperformuese




Rritja e stokut të kredive prej 10.1 përqind si dhe rënia e stokut të kredive jo performuese për 16.0 përqind ndikuan në rënie të raportit të KJP-ve (grafik 41). Sidoqoftë, shpërthimi i pandemisë Covid-19 si dhe efekti i masave parandaluese të përhapjes së saj në performancën e ndërmarrjeve dhe të hyrat e ekonomive familjare, do të ndikojnë në rritjen e rrezikut kreditor në periudhën në vijim.

Shlyerja e kredive joperformuese nga bilanci i gjendjes së bankave ishte faktorë që ndikoi në rënie të vlerës së kredive joperformuese. Në dhjetor 2019 vlera e kredive të shlyera ishte 6.6 milionë euro, që në terma absolut ka ndikuar në zvogëlimin e gjithsej kredive jo performuese për 9.7 përqind. Kthimi i kredive të kategorizuara si jo performuese dha kontribut zbritës prej 10.7 përqind, por i cili u neutralizua në tërësi nga origjinimet e kredive jo performuese gjatë kësaj periudhe, të cilat patën efekt rritës prej 11.3 përqind në gjithsej stokun e kredive jo performuese (grafik 42).

Faktorë tjerë si rritja e aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i faktorëve strukturorë kanë

ndikuar gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore.

Grafik 42. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs)




Një pjesë e efektit të rënies së KJP-ve mund t'i atribuohet edhe faktorëve të tjerë si performanca e mirë financiare e sektorit të ndërmarrjeve gjatë këtij viti, e bazuar në treguesin e klimës së biznesit²⁶, që mund të ketë kontribuar në aftësinë paguese të këtyre huamarrësve. Po ashtu, aktiviteti i përmbaruesëve privat ka mundësuar lehtësimin dhe përsheptimin e procesit të kthimit të kredive, ndërsa avansimi në reformat strukturorë për lehtësim në realizimin e kolateralit, ka ndikuar në rritjen e konfidencës së bankave dhe rrjedhimisht rritjen e vëllimit të kredive të lëshuara nga bankat. Këta faktorë u reflektuan në rikuperim të kredive joperformuese gjatë periudhës.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi pozicionimin në nivelin më të mirë në rajon për nga cilësia e portfolios kreditore (grafik 43). Kosova ndër vite qëndron me raportin më të ulët të kredive jo performuese krahasuar me vendet e rajonit, të cilat gjithashtu kanë vazhduar trendin e përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore. Sidoqoftë, pritjet janë që ky trend të ndërroj kahje për të gjitha vendet përfshirë Kosovën, si rezultat i pasojave të pandemisë Covid-19. Magnituta e përkeqësimit të cilësisë kreditore në masë të madhe do të varet nga mënyra e menaxhimit të pandemisë, kohëzgjatja dhe

²⁶ Për më tepër lexo seksionin 3.3 Pozicioni financiar i ndërmarrjeve.


shtrirja e masave për parandalimin e saj, masave mbështetëse të qeverive dhe autoriteteve përkatëse, dhe specifikave në strukturën e ekonomisë së vendeve.

Grafik 43. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit



Ekspozimet kreditore me klasifikim më të lartë kreditor, kreditë standarde, kanë vazhduar trendin e rritjes së pjesëmarrjes në portfolion kreditore, dhe në dhjetor 2019 përfaqësonin 96.0 përqind të gjithsej kredive.

Grafik 44. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave




Kreditë standarde, të cilat përfshijnë ekspozimet kreditore pa vështirësi, me vonesa më pak se 30 ditë, ose plotësisht të mbuluara me kolateral, në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen, ku në dhjetor 2019 rritën peshën për 1.2 pikë përqindje në favor të zvogëlimit të peshës së kredive me klasifikim më të ulët si “vrojtuese”, “nënstandard” dhe “të humbura” për 0.2, 0.4 dhe 0.6 pikë përqindje (grafik 44).

Segmenti më i kredituar dhe njëkohësisht më i ngarkuar nga kreditë jo performuese është segmenti i ndërmarrjeve. Ky segment përfaqëson rreth 65.2 përqind të gjithsej portfolios kreditore. Raporti i kredive

jo performuese për ndërmarrje u zvogëlua në 2.5 përqind nga 3.4 përqind sa ishte në vitin paraprak (grafik 45).

Grafik 45. Kreditë joperformuese




Sipas aktivitetit ekonomik, pothuajse të gjithë sektorët janë karakterizuar me përmirësim të portfolios kreditore. Raporti i KJP-ve për sektorin e tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, zbriti në 2.6 përqind nga 3.7 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, sektori i bujqësisë edhe pse vazhdon të ketë normën më të lartë të KJP-ve, ishte për 2.5 pikë përqindje më ulët se në vitin paraprak, duke zbritur në 3.5 përqind. Ky sektor që përfaqëson sektorin më strategjik të ekonomisë është një ndër sektorët më pak të kredituar nga ana e bankave, ku vetëm 2.8 përqind e gjithsej stokut të kredive janë të destinuara për bujqësi. Sektori i prodhimitarisë gjithashtu shënoi përmirësim më të theksuar në normën e KJP-ve nga 4.6 përqind në 2.8 përqind (grafik 46). Rritja e shfrytëzimit të FKGK, i cili garanton deri në 50% të kryegjësë së kredisë për NVM-të duke mbuluar një pjesë të rrezikut të tyre kreditor, vlerësohet të jetë reflektuar në rritjen e kreditimit për sektorët më strategjik si bujqësia e prodhimi, që historikisht janë kredituar më pak për shkak të rrezikut më të lartë kreditor që bartin këta sektorë.

Cilësia e portfolios kreditore do të përkeqësohet si rezultat i ndikimeve të krizës ekonomike të nxitur nga pandemia Covid-19. Ndërprerja për një kohë e aktivitetit ekonomik dhe sfidat në funksionim normal të ndërmarrjeve, do të ndikojnë ndjeshëm në aftësinë e tyre për realizimin e të ardhurave, e që pashmangshëm do të krijoj


vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare. Kjo situatë do të reflektohet në rënie të cilësisë së portfolios kreditore në pothuajse të gjithë sektorët ekonomik.

Grafik 46. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve



Cilësia e portfolios kreditore të ekonomive familjare mbeti në nivel të lartë, përkundër trendit rritës të kredive, posaçërisht të atyre konsumuese. Stoku i kredive jo performuese të ekonomive familjare u rrit për 2.4 përqind, mirëpo rritja më e madhe e bazës së kreditimit ndikoi që raporti i KJP-ve të zbrit për 0.1 pikë përqindje në 1.1 përqind në dhjetor 2019.

Grafik 47. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



Por, rreziku kreditor për ekonomitë familjare pritet të rritet në periudhën vijuese. Kriza e krijuar nga pandemia Covid-19 do të ndikoj edhe pozicionin financiar të ekonomive familjare, pasi rënia e aktivitetit të

ndërmarrjeve do të sjellë reduktim të të ardhurave, ndërprerje të plotë të pagës dhe humbje të vendeve të punës.

Kufizimet në lëvizje do të krijojnë rënie të remitencave përmes kanaleve jo-formale, duke ndikuar në nivelin e të ardhurave të shumë familjeve. Në një efekt zinxhir, kjo gjendje do të ndikoj në dobësimin e mëtejshëm të konsumit dhe në vështirësi për të përmbushur detyrimet financiare.

Raporti i provizionimit të sektorit është rritur tutje në gjysmën e dytë të vitit 2019, duke arritur në 163.5 përqind në dhjetor 2019. Rritja në normën e provizionimit i atribuohet kryesisht përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore, përkatësisht rënies vjetore prej 16 përqind të vlerës së kredive jo performuese, ngase vlera e provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë zbriti për 9.7 përqind. (grafik 47).

Në dhjetor 2019, niveli i provizioneve të sektorit bankar ishte i lartë, mbi kërkesat rregullore, ku provizionet e tepërta përbënin 44.4 përqind të gjithëj stokut të provizioneve të mbajtura. Raporti i mbulimit të kredive jo performuese neto nga provizionet²⁷ ndaj kapitalit rregullator mbeti në nivelin e njëjtë si një vit më parë, në 1.5 përqind. Kërkesat për provizione pritet të rriten në periudhën në vijim, si rezultat i përkeqësimit të pritur në portfolion kreditore të bankave të ndikuar nga kriza e nxitur nga pandemia Covid-19.

5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

Shkalla e ekspozimit kreditor është rritur në 81.8 përqind nga 68.7 përqind sa ishte në vitin paraprak, por është dukshëm nën nivelin maksimal rregullator.²⁸ Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha për 22.1 përqind krahas rritjes më të ngadalshme të kapitalit të klasit të parë për 2.5 përqind ndikuan në ngritjen e shkallës së ekspozimit (grafik 48).


²⁷ Kreditë joperformuese neto përfaqësojnë vlerën e kredive joperformuese që mbetet pasi t'i zbriten provizionet për këto kredi.

²⁸ Raport i gjithëj Ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj Kapitalit të Klasit të parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të

vetëm ose grup të ndërlidhur personat vlera e të cilit tejkalon 10% të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditore së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300% të kapitalit të klasit të parë.

Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, është rritur. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha²⁹ arriti në 5.9 milionë euro nga 5.3 milionë euro si rezultat i efektit të rritjes më të lartë të vlerës së ekspozimeve, ngase numri i ekspozimeve shënoi rritje gjithashtu.

Grafik 48. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2020)

Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore shënoi rënie në 51.1 përqind nga 57.2 përqind. Shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore në vitin 2019 është ngritur si rezultat i rritjes së ekspozimeve nga bankat më të mëdha, me rëndësi sistematike. Në masë të madhe, shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore ndryshon edhe nga veprimet e bankave që operojnë si degë të huaja, të cilat kanë shkallën më të lartë të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë, dhe të cilat rezultojnë me ndjeshmërinë më të lartë në analizën e qëndrueshmërisë së goditjeve të mundshme në ekspozimet kreditore.³⁰

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve në tri dhe pesë ekspozimet më të mëdha të bankave, në përgjithësi tregojnë për ndjeshmëri të sektorit ndaj goditjeve në këto ekspozime. Andaj, megjithëse sektori qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione. Kriza e

²⁹ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.


³⁰ Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto banka nuk janë subjekt i rregullativës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të

shkaktuar nga Covid-19 mund të rrisë rrezikun në aspektin e performimit të këtyre ekspozimeve ndaj dhe kjo situatë rritë nevojën për qasje pro-aktive dhe dinamike në menaxhimin dhe trajtimin e ekspozimeve të mëdha

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Profiti i sektorit bankar të Kosovës shënoi rënie vjetore prej 2.0 përqind, ndikuar nga rritja e të gjitha kategorive të shpenzimeve. Vlera e profitit neto zbriti në 86.2 milionë euro nga 88.0 milionë në vitin paraprak (grafik 49).

Grafik 49. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)


Kontribuesit kryesorë të rritjes së shpenzimeve, dhe njëherit rënies së profitit, ishin shpenzimet e interesit në depozita, që reflekton rritjen e kostonë së financimit për bankat, pasuar nga shpenzimet për tarifatat dhe komisionet (grafik 50).

Përkundër rritjes së shpenzimeve të interesit, të hyrat neto nga interesi për sektorin bankar u rritën për 4.9 përqind si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave nga aktiviteti kreditor. Por, margjina neto e interesit shënoi rënie në 4.8 përqind nga 5.1 përqind vitin paraprak, si rezultat i rritjes më të lartë të stokut të aseteve që sjellin interes, rritje prej 10.3 përqind respektivisht (grafik 51).

bankave amë, prandaj edhe vlera e ekspozimeve të mëdha kreditore është më e lartë tek këto banka.


Gjithsej të hyrat nga interesi u rriten për 13.2 milionë euro (apo 7.0 përqind). Ndërsa vetëm të hyrat nga interesi në kredi shënuan rritje vjetore për 6.0 përqind apo 10.8 milionë euro, dhe ishin ndër kontribuesit kryesor në realizimin e profitit.

Grafik 50. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit



Zgjerimi i aktivitetit kreditor gjatë vitit 2019 kontriboi në rritjen e të hyrave të interesit nga kreditë, ngase norma mesatare e interesit në kredi ka shënuar rënie të lehtë (mesatarja vjetore e interesit në kredi të reja në vitin 2019 ishte 6.51 përqind krahasuar me 6.65 përqind në vitin 2018).³¹

Grafik 51. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit




Të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet si dhe të ardhurat tjera operative) shënuan rënie prej 6.4 përqind, duke zbritur në vlerën 60.6 milionë euro. Gjithashtu shpenzimet e jo-interesit u rritën, kryesisht si rezultat i shpenzimeve më të larta për tarifa dhe

³¹ Duke qenë se rreth 90 përqind e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi realizohen nga aktiviteti ndërmjetësues, atëherë të hyrat neto nga interesi ndikohen direkt nga ndryshimet në normat e interesit në kredi dhe depozita (grafik 55 dhe 56).


komisionet, duke ndikuar në rënie të të hyrave neto nga jo-interesi (grafik 52).

Figura 52. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit



Ndikuar nga rritja e presioneve të bankave për zgjerimin e bazës së depozitave, shpenzimet për interesa, për dallim nga vitet paraprake, ndërruan kahje dhe shënuan rritje prej 4 milionë euro (apo 28.1 përqind). Kjo si rezultat i rritjes së normës mesatare të interesit në depozita (në 1.46 përqind apo rritje për 0.15 pikë përqindje³²) dhe i rritjes së theksuar vjetore të depozitave, prej 16 përqind. Megjithatë, pjesa më e madhe e zgjerimit të depozitave përbëhet nga kategoria e depozitave të transferueshme, të cilat nuk paraqesin shpenzim për bankat.

Grafik 53. Struktura e të hyrave të sektorit bankar




Profiti i sektorit bankar pritet të ballafaqohet me presionin e shkaktuar nga kriza e pandemisë Covid-19. Rënia e kreditimit dhe rritja e nevojës për ndarje

³² Duke qenë se rreth 90 përqind e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi realizohen nga aktiviteti ndërmjetësues, atëherë të hyrat neto nga interesi ndikohen direkt nga ndryshimet në normat e interesit në kredi dhe depozita (grafik 55 dhe 56).

të shpenzimeve për provizione për të mbuluar humbjet e mundshme, do të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve. Përkundër rritjes së rrezikut kreditor, presionet e konkurrencës si dhe rënia e mundshme e kërkesës për kredi, do të ndikojnë në kufizimin e mundësive që bankat të rrisin normën e kreditimit. Ndërsa, norma veçse e ulët e interesit në depozita, si dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme (rreth 60 përqind e gjithsej depozitave) të cilat nuk bartin shpenzime interesi, bën që mundësitë për efekte pozitive në realizimin e profitit nga menaxhimi i shpenzimeve për interesa, të jenë të kufizuara. Prandaj, duke pasur parasysh këtë dhe deklaratimet e bankave në anketën e kreditimit bankar që sinjalizojnë për rënien e kreditimit dhe rritjen e rrezikut kreditor, pozita aktuale e profitabilitetit do të ballafaqohet me presione rënëse.

Ndikim pozitiv i pandemisë Covid-19 në performancën e bankave mund të jetë intensifikimi i përpjekjeve të bankave për digjitalizim të shërbimeve, si dhe rritja e kërkesës apo shfrytëzimit nga klientët të këtyre shërbimeve. Për pasojë, sektori mund të përfitojë në rritje të efikasitetit të menaxhimit të kostove dhe rënie të shpenzimeve operative.


Grafik 54. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar



Indikatorët e profitabilitetit u zvogëluan si rezultat i rënies së profitit, megjithatë vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të

lartë në rajon. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës zbriti në 2.2 përqind, përkatësisht 18.9 përqind nga 2.5 përqind dhe 20.4 përqind një vit më parë (grafik 55). Këto nivele janë mjaft mbi mesataren e rajonit që shënoi normë të kthimit në asete prej 1.4 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 11.0 përqind.³³

Grafik 55. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2020)

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë nga bankat në njërën anë, dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave me afat më të shkurtër maturimi në anë tjetër, në përgjithësi kanë rritur ekspozimin e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit, ngase kanë rritur mospërputhjen e maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve që bartin interes.


Në vitin 2019, hendeuku kumulativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit është rritur.

Por, bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi, andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Në afat të shkurtër, rritja e mundshme e kostos së financimit, mund të ndikojë në rritjen e presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë

³³ Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Herzegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi.


kategoria kryesore e asetëve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë.

Grafik 56. Hendeku kumulativ i asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit



Krahasuar me vitin paraprak hendeku u ngushtua në të gjitha afatet e maturimit, përveç në afatin '91-365 ditë' ku pati zgjerim. Hendeku pozitiv për afate të maturimit mbi 1 vit u ngushtua si rezultat i rritjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi dhe rritjes së borxhit të ndërvarur, ndërsa hendeku pozitiv për afatin e maturimit '91-360 ditë' u zgjerua si rezultat i rritjes së kredive më afat-shkurtra ndaj klientëve (grafik 57).

Grafik 57. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit




Ky zhvillim i ngushtimit të mospërputhjeve të afatave të maturimit mes asetëve dhe detyrime paraqet zhvillim pozitiv në uljen e ekspozimit ndaj rrezikut në luhatjen e normave të interesit për periudhat kohore përkatëse, ngase zvogëlon bilancin e shpenzimeve që ndodhin për refinancimin e bilancit të gjendjes dhe të hyrave që gjenerohen nga riinvestimi i mjeteve.

5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kurset valutore është rritur krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rritjes së pozicioneve të hapura neto në valutë. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja u ngrit në 24.4 milion euro ekuivalente nga 5.9 milion, që konsiston në 5.0 përqind të kapitalit të klasit të parë nga 1.3 përqind sa ishte në dhjetor 2018 (grafik 58).

Grafik 58. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë




Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto i disagreguar ndaj kapitalit të klasit të parë u rrit për të gjitha valutat, kryesisht si rezultat i rritjes së asetëve në valutë. Për të gjitha valutat, pozicioni neto i hapur rezulton pozitiv, që nënkupton se bankat posedojnë më shumë asete në valutë se sa detyrime. Kjo do të thotë se sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të këtyre valutave ndaj euros.

Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve të hapura në valuta të huaja. Kjo dëshmohet edhe përmes analizës 'stres test' që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase

kreditë në valutë mbeten në nivel të papërfillshëm. Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.1 përqind të gjithsej kredive, rritje prej 0.3 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grafik 59. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 4.2 përqind në dhjetor 2019, që paraqet rënie vjetore prej 4.9 milionë euro (grafik 59).

5.4. Kapitali

Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me nivel të lartë të treguesve të kapitalit, përkundër rënies së lehtë që shënuan gjatë periudhës. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua në 15.8 përqind nga 17.0 përqind në dhjetor 2018 (grafik 60).

Grafik 60. Kapitalizimi i sektorit bankar




Kjo rënie reflekton rritjen e aseteve të peshuara me rrezik, 11.7 përqind rritje vjetore, e cila erdhi si pasojë e rritjes së aktivitetit

kreditor. Kapitali rregullator ka shënuar rritje gjithashtu, 4.2 përqind rritje vjetore, por efekti më i lartë i rritjes së aseteve me peshë rreziku se i rritjes së kapitalit rregullator e zbriti treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit për 1.1 pp (grafik 61).

Pavarësisht rënies së treguesve të kapitalit, sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 89.4 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë. Profiti i lartë i realizuar dhe ai i mbajtur kanë pjesëmarrjen të lartë në kapital të klasit të parë, e që njëherit informon që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre (mbajtjes së profitit si ekuitet).

Në kuadër të kapitalit rregullativ rritje shënuan kapitali aksionar dhe fitimi i mbajtur nga vitet paraprake, si dhe borxhi i ndërvarur. Ndërsa, shpërndarja e dividendës nga bankat, që e ndikon kapitalin përmes reduktimit të fitimit të pashpërndarë, si dhe huazimet nga personat e ndërlidhur, ishin zërat me efekt reduktues në kapitalin rregullativ.

Grafik 61. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Sipas bankave individuale, tri nga bankat më të mëdha kanë shënuar rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, si rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku, por edhe zbritjes së nivelit të kapitalit rregullativ. Krahas zvogëlimit në treguesin e mjaftueshmërisë, i cili megjithatë vazhdon të jetë më i lartë se mesatarja e sektorit, këto banka kanë zvogëluar gjithashtu profilin e rrezikut, shprehur përmes raportit të aseteve me rrezik ndaj gjithsej aseteve. Pothuajse të gjitha bankat kishin rritje më të

lartë të gjithsej aseteve kundrejt aseteve të peshuara me rrezik, që reflektohet edhe në faktin që profili i rrezikut për gjithsej sektorin ka shënuar rënie

Leva financiare po ashtu u zvogëlua si pasojë e rritjes më të lartë të aseteve kundrejt ekuitetit. Indikator i levës financiare (raporti i ekuitetit ndaj aseteve) zbriti në 11.2 përqind nga 12.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke sugjeruar zvogëlim të financimit të aktivitetit përmes kapitalit aksionar në raport me financimin përmes borxhit (grafik 62).


Grafik 62. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK (2020)

Në kuadër të aseteve të peshuara me rrezik, rritjen më të theksuar e shënuan asetet e peshuara për rrezik kreditor. Duke qenë se modeli i biznesit të sektorit bankar është kryesisht aktiviteti kreditor, 92.7 përqind e kërkesave kapitale për rreziqe janë destinuar për rrezikun kreditor ndërsa 7.3 përqind për atë operacional (grafik 63).

Grafik 63. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit




Burimi: BQK (2020)

Në dhjetor 2019, asetet me peshë të rrezikut kreditor u rritën për 352.4 milionë euro (apo

12.5 përqind rritje vjetore), duke arritur në 3.2 miliardë euro. Të gjitha kategoritë shënuan rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e aseteve të peshuara më rrezik e dhanë asetet me peshë rreziku 100% që shënuan rritje vjetore prej 11.2 përqind, e të cilat edhe dominojnë gjithsej APR-të (grafik 64).


Grafik 64. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2020)

Kreditë ndaj sektorit privat dhe publik përfshijnë 88.2 përqind të gjithsej kredive me peshë rreziku 100%, përdërisa kreditë ndaj institucioneve tjera financiare kryesisht, 73.9 përqind e tyre, janë të peshuara me rrezik prej 20% (grafik 65).

Grafik 65. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2020)

Niveli i mbajtjes së kapitalit për rrezik operacional ka shënuar rritje të qëndrueshme ndër vite krahas rritjes së vazhdueshme të ekspozimit ndaj këtij rreziku. Revolucioni digjital ka ndikuar në çdo aspekt, përfshirë këtu edhe ndikimin në sistemin financiar duke nxitur adoptimin gjithnjë e më shumë të sistemeve të avancuara të teknologjisë dhe të krijimit të infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve të

digjitalizuara. Këtyre zhvillimeve u janë ekspozuar edhe bankat në Kosovë të cilat posaçërisht në vitet e fundit kanë investuar mjaft në ofrimin e shërbimeve elektronike bankare. Shpërthimi i pandemisë Covid-19 pritet të nxitë përshpejtimin e këtij trendi. Andaj, rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara pritet të rrisë shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike, duke rritur kështu nevojën për mbikëqyrje dhe vlerësim të rrezikut operacional.

Menaxhimi adekuat i rrezikut operacional është çështje shumë e rëndësishme nga pikëpamja e stabilitetit financiar pasi që rreziku operacional njëkohësisht mund të paraqes rrezik sistemik për shkak të humbjeve por edhe të panikut që mund të përhapet. Në vitin 2019, kërkesat për ndarje të kapitalit për mbulimin e humbjeve të mundshme operationale qëndruan në vlerën prej 249.0 milionë euro, për 3.3 përqind më e lartë se në vitin paraprak. Në vitin 2019, menaxhimi i rrezikut operacional vlerësohet adekuat, duke mos pasur raste të materializimit të tij, si dhe duke ndarë kapitalin për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit


Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të bankave vazhdon të përfaqësohet nga depozitat të cilat shënuan rritje, kryesisht nga ekonomitë familjare. Nën ndikimin e normave të ulëta të interesit pjesëmarrja e depozitave të transferueshme është zgjeruar, që në kombinim me rritjen e kreditimit afatgjatë kontribuan në theksimin e mospërputhjeve të maturimeve në mes të këtyre zërave. Megjithatë, indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit të bankave që mbahen në BQK por edhe i gjithsej aseteve likuide, e bën sektorin më rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë nga mospërputhjet e afateve të maturimit në mes të investimeve dhe

financimit. Në periudhën në vijim, kriza e nxitur nga pandemia Covid-19 mund të rrisë presionin mbi gjendjen e likuiditetit të sektorit përmes efektit të ngadalësimit të rritjes së depozitave si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik dhe burimeve të jashtme të financimit. Në një periudhë kur kërkesat për financim dhe likuiditet nga sektori privat do të rriten, presioni për menaxhimin e likuiditetit nga bankat mund të rritet. Në mungesë të mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg nga BQK, nevoja për likuiditet dhe financim mund të menaxhohen përmes menaxhimit të rezervave, marrëveshjeve ndërbankare për likuiditet si dhe financimit nga jashtë përmes bankave amë.

5.5.1 Financimi bankar

Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga financimi prej sektorit jo-bankar, kryesisht depozitave të cilat vazhduan rritjen. Në dhjetor 2019, depozitat përbënin 82.2 përqind të financimit, përderisa vetëm depozitat e sektorit privat (ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare) konsistojnë në 85.6 përqind të gjithsej depozitave, gjë që tregon se financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët dhe se bankat janë shumë pak të ekspozuara ndaj financimit në sektorin e jashtëm (grafik 66).

Grafik 66. Struktura e financimit




Burimi: BQK (2020)

Depozitat shënuan rritje vjetore prej 16.2 përqind duke arritur në vlerën prej 3.9 miliardë euro. Ndërsa vetëm depozitat e sektorit privat arritën në 3.3 miliardë euro, dhe u rritën me normë vjetore prej 14.2

përqind. Bankat vazhdojnë të financojnë aktivitetin e rritur kreditor kryesisht nga depozitat. Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 129.6 përqind, tregues që u rrit për 6.8 pikë përqindje nga viti paraprak, nën ndikimet e zgjerimit më të madh të depozitave (grafik 67).

Grafik 67. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar




Burimi: BQK (2020)

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit, vazhduan rritjen pavarësisht mbizotërimit të normave të ulëta të interesit në treg (grafik 68).

Trendi i rritjes vazhdoi edhe këtë vit, me ritëm të përsheptuar prej 11.5 përqind nga 7.5 përqind në dhjetor 2018. Stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti në 2.6 miliardë euro.

Grafik 68. Struktura e depozitave




Burimi: BQK (2020)

Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme, të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 13.7 përqind kontribuan në rritjen e gjithshje depozitave të ekonomive familjare (grafik 69).

Depozitat e ndërmarrjeve përsheptuan trendin e rritjes në 25.0 përqind rritje vjetore, të mbështetur nga performanca

pozitive financiare e ndërmarrjeve si dhe nga rritja e normës mesatare të interesit në këto depozita gjatë këtij viti.

Grafik 69. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK (2020)

Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 744.9 milionë euro, me pjesëmarrje 19.1 përqind në gjithshje depozitat. Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 29.4 përqind, për shkak të efektit të bazës. Depozitat e afatizuara u karakterizuan me rënie prej 6.7 përqind, përkundër rritjes së lehtë për 0.15 pikë përqindje e normës mesatare të interesit për këto depozita gjatë vitit 2019, e cila arriti në 1.46 përqind.

Struktura e gjithshje depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 18.0 përqind. Depozitat e transferueshme arritën në 60.9 përqind të gjithshje depozitave në dhjetor 2019 (grafik 69). Ndërsa, 38.3 përqind e gjithshje depozitave përbëhet nga depozitat e transferueshme të ekonomive familjare. Depozitat e afatizuara shënuan rritje të theksuar vjetore prej 17.7 përqind, po ashtu edhe depozitat e kursimit shënuan rritje vjetore prej 5.9 përqind duke ndalur trendin rënës të tre viteve të fundit. Mbizotërimi i normave të ulëta të interesit mbi depozita të kursimit po reflekton dekurajim të kursimit tek ekonomitë familjare, përderisa e kundërta ndodh me depozitat e afatizuara ku pasqyrohet ndikimi i rritjes së normës së interesit në këto depozita edhe pse në nivel ende të ulët. Sidoqoftë, pandemia Covid-19 mund të ketë ndikim negativ edhe mbi

depozitat e afatizuara dhe të kursimeve për shkak të pasigurive të shtuara në mundësinë e realizimit të të ardhurave kundrejt stagnimit të aktiviteteve në ekonomi, rrjedhimisht mund të zvogëlohet hapësira për investimin e parave në këto instrumente.

Grafik 70. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive



Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’. Depozitat me afat maturimit ‘deri në 1 vit’ edhe pse me pjesëmarrjen në ulje nga 40.6 përqind në 32.0 përqind, dominuan strukturën e depozitave të afatizuara. Përderisa, kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ janë ato që kanë pjesëmarrjen më të lartë (prej 38.8 përqind) në gjithsej kreditë dhe të cilat deri në dhjetor 2019 zgjeruan tutje pjesëmarrjen e tyre (grafik 70).

Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe e dominimit të depozitave me maturim afatshkurtër në njërën anë, dhe në anën tjetër rritja e kreditimit afatgjatë shton nevojat për rishikim të financimit të qëndrueshëm të bankave. Mirëpo, rritja e financimit gjatë vitit në vijim mund të vështirësohet si pasojë e rënies së burimeve të financimit dhe mundësisë së rritjes së kostos të financimit si pasojë e pandemisë Covid-19.

5.5.2 Rreziku i Likuiditetit


Spektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit, përkundër

³⁴ Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është i definuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit prej 25% (neni 17. Norma e likuiditetit)

rënies së lehtë të raportit indikatorëve të likuiditetit. Në dhjetor 2019 raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 37.6 përqind krahasuar me 38.5 përqind në dhjetor 2018. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtra se sa rritja e aseteve likuide prej 13.7 përqind, dhe 10.9 përqind respektivisht.

Po ashtu edhe raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve u zvogëlua lehtësisht në 28.0 përqind (28.9 përqind në dhjetor 2018), si rezultat i rritjes më të lartë të gjithsej aseteve kundrejt aseteve likuide (grafik 71). Sidoqoftë, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra më i lartë se minimumi rregullator³⁴ tregon për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditues.

Grafik 71. Indikatorët e likuiditetit




Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi nga rritja prej 71.8 milionë euro e bilancit të rezervave me BQK-në, apo një rritje vjetore prej 21.0 përqind, si dhe rritja e fletëobligacioneve të qeverisë së Republikës së Kosovës prej 59.5 milionë euro, apo rritje vjetore prej 49.2 përqind. Ndërsa, rënie shënuan bonot e thesarit të Republikës së Kosovës prej 49.6 përqind, të cilat nuk e afektuan në masë të madhe stokun e aseteve likuide për shkak të pjesëmarrjes së ulët. Peshat e rezervave të likuiditetit me BQK-në u rrit në 31.9 përqind të aseteve likuide, duke vazhduar të jetë kategoria kryesore. **Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të**

larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 57.0 përqind. Nga gushti i vitit 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepricën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me vendimin e BQE-së për aplikim të normave negative në depozita.

Aplikimi i normës negative ndikoi tepricën e rezervës menjëherë në muajin vijues, ku në shtator të vitit 2016 teprica u zvogëlua për 29.9 përqind (grafik 72).³⁵ Megjithatë, nuk janë vërejtur efekte afatgjata të masave të ndërmarra përmes normës negative në nivelin e tepricës së rezervës, potencialisht për shkak të mundësive të kufizuara për ruajtje apo edhe investim të mjeteve.

Grafik 72. Rezervat e likuiditetit




Ambienti i normave të ulëta të interesit është duke stimuluar ekonomitë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përshpejtimin të kreditimit afatgjatë ka rezultuar në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve në dhjetor 2019. Depozitat e ndërmarrjeve e posaçërisht të ekonomive familjare janë burim i financimit të aktivitetit të rritur kreditor të bankave. Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit po rriten në kushtet kur depozitat e transferueshme janë rritur dhe

³⁵ Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendencat për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse. Teprica e

afatet e maturimit të kredive janë zgjatur, lëvizje kjo që rritë ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

Hendeku kumulativ i likuiditetit u zgjerua në 513.6 milionë euro nga 494.4 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar kryesisht zgjerimi më i theksuar i hendekut pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të afateve të maturimit 6 muaj deri në 1 vit. Zgjerim të hendekut pozitiv kishin të gjitha kategoritë e afateve të maturimit. Rreth 37.1 përqind e gjithsej asetëve kategorizohen në afatin '1-5 vite' në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë vetëm 12.6 përqind të gjithsej detyrimeve.

Grafik 73. Hendeku i likuiditetit*



Hendeku negativ rezulton vetëm në afatin e maturimit '1-7 ditë', vlera e të cilit qëndron në -1.96 miliardë euro. Në këtë kategori të afatit të maturimit bëjnë pjesë 70.8 përqind e gjithsej detyrimeve, ndërsa asetet konsistojnë 20.7 përqind. Rrjedhimisht mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit '1-7 ditë' dhe '1-5 vite' (grafik 73). Kjo situatë paraqet sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave dhe në të ardhmen mund të kufizoj mundësitë në favor të kreditimit afatgjatë.

rezervës në tremujorin e tretë të këtij viti ishte për 49.0 përqind më e lartë se në tremujorin e dytë, ndërsa në dhjetor teprica ishte për 18.7 përqind më e lartë se në muajin nëntor.

5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test³⁶

Analiza 'stress test' tregon qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj goditjeve në portfolion kreditorë dhe pozitën e likuiditetit sipas skenarëve të supozuar si pasojë e zhvillimeve të pafavorshme makroekonomike dhe ndryshimeve në kushtet e tregut. Mirëpo, në këtë publikim nuk janë përfshirë skenarët e goditjeve makroekonomike dhe financiare në portfolion kreditorë dhe pozitën kapitale, pasi që modeli aktual i analizës nuk është i kalibruar për mbulimin e krizave të paprecedent si kriza e pandemisë Covid-19. Konkretisht, koeficienti i elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj BPV-së dhe hendekut të prodhimit, që tregon ndjeshmërinë e portfolios kreditorë ndaj zhvillimeve makroekonomike të supozuara, është modeluar duke mos përfshi asnjë situatë krize në historikun e sektorit bankar në Kosovë.

Një analizë e ndjeshmërisë së kredive joperformuese bazuar në të dhënat deri në dhjetor 2019, sugjeron që pragu i raportit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në nivel sektori është 16.3 përqind, ku për të mbuluar këtë nivel të kredive joperformuese sektorit do t'i duheshin 208.5 milionë euro shtesë. Niveli i KJP-ve gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 është menaxhuar përmes shtyrjes së kësteve të kredive si masë lehtësuese e ndërmarrë nga BQK. Deri në qershor 2020, 63.2 përqind e gjithsej kredive aktive aplikuan për shtyrje, e prej të cilave u aprovuan 60.7 përqind.

5.6.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësojë aftësinë financuese të bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet

e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga dështimi i depozitave të koncentruara. Skenarët janë mjaftë konservativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore

Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të tërheqjeve në baza ditore (tabela 6), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite ndahen 5 përqind të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jolikuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

Këto nivele të supozuara të tërheqjeve ditore janë bazuar në eksperiencat e sektorit bankar të vendeve të rajonit, të cilat kanë përjetuar situatat të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave, si pasojë e pasigurive të shkaktuara në masë nga destabiliteti politik dhe rrethana të krizave të tjera financiare të ndodhura në periudha të ndryshme. Prandaj, përderisa Kosova nuk ka historik të ngjarjeve të tilla, bazuar në praktikën e vendeve të rajonit është supozuar që në situata krize ky nivel i tërheqjeve do të mund të materializohet.

Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që bankat do të mund të përballonin tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore deri në ditën e dytë. Në ditën e pestë probleme me likuiditet do të paraqiteshin në shtatë banka, duke përfshirë këtu edhe bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë për këto banka do

³⁶ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve negative, pa

paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

të arrinte në 136.8 milionë euro (grafik 74, tabela 7). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në sektorin bankar në ditën e

pestë do të arrinte në 38.2 përqind (grafik 75, tabela 7).

Tabela 6. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit


Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK (2020)

Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj

Pozita e likuiditetit të bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë humbjet, përjashtuar një bankë, nën supozimet e skenarit mbi tërheqjet e mundshme të depozitave nga pesë depozitarët më të mëdhenj në secilën bankë.

Grafik 74. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - skenari 1



Ndërsa nën supozimin se njëzet depozitarët më të mëdhenj të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohej edhe në një bankë tjetër. Mungesa e mjeteve për këto dy banka do të arrinte në 24.0 milionë euro (tabela 7). Rezultatet e këtij skenari përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të

financimit, që janë depozitat si përbërës kryesor i detyrimeve.

5.6.2 Niveli përballues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Problemet me likuiditet për tërë sektorin bankar do të paraqiteshin në rast të tërheqjes së 24.3 përqind të depozitave brenda ditës, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të katërtës (1/4) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë (grafik 75 dhe tabela 7). Ndërsa në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 15.6 përqind, ndërsa banka me më të lartin në 32.3 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedon kjo bankë).

Grafik 75. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - skenari 2




Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	7	-38.2%	(136,837)	125.3%
Skenari 2.1: Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenjë	1	-11.3%	(1,829)	87.3%
Skenari 2.2: Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenjë	2	-17.5%	(23,979)	93.9%
Pragu - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-24.3%	(39,076)	102.3%

Burimi: BQK (2020)


6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Aktiviteti i sektorit pensional

Performanca e mirë financiare si dhe të ardhurat stabile nga kontributet e arkëtuara ndikuan në zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit të sektorit pensional gjatë vitit 2019. Mirëpo, gjatë vitit në vijim, sektori pensional mund të ndikohet negativisht nga përhapja e pandemisë COVID-19. Kthimi në investime mund të pësojë rënie si rrjedhojë e pasigurisë së shkaktuar në tregjet e jashtme financiare dhe recesionit ekonomik të shkaktuar nga masat e ndërmarra për të luftuar COVID-19. Po ashtu, edhe të hyrat nga kontributdhënësit priten të jenë në nivel më të ulët si rezultat i tkurrjes ekonomike në vend dhe rritjes së shkallës së papunësisë gjatë vitit në vijim.

Grafik 76. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK (2020)


Në vitin 2019, sektori pensional u karakterizua me rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve prej 17.0 përqind, përderisa vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit arriti në 1.98 miliard euro (grafik 76).

Kjo rritje i atribuohet kryesisht performancës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që përfaqësojnë pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.6 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Arkëtimet e reja

shënuan rritje vjetore prej 8.1 përqind, vlera e të cilave arriti në 186.6 milionë euro në vitin 2019, përderisa kthimi nga investimet gjatë kësaj periudhe arriti vlerën në 161.9 milion euro (-84.9 milionë euro në vitin 2018).

Struktura e aseteve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm. Në vitin 2019, portfolio investuese në tregjet e huaja u rrit për 20.6 përqind (rënie për 17.0 përqind në vitin paraprak).

Grafik 77. Struktura e investimeve të sektorit pensional



Burimi: BQK (2020)

Si rrjedhojë, investimet jashtë vendit rritën pjesëmarrjen në 75.2 përqind të gjithsej aseteve (73.0 përqind në vitin 2018), ndërsa investimet brenda vendit zvogëluan pjesëmarrjen në 24.8 përqind (27.0 përqind në vitin 2018) (grafik 77).


Në kuadër të investimeve brenda vendit, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdojnë të jenë kategoria me peshën më të madhe, pasuar nga ajo e certifikatave të depozitit dhe parasë së mbajtur në vend. Peshat e letrave me vlerë u rrit në 61.3 përqind (46.0 përqind në vitin 2018), ndërsa e certifikatave të depozitit u rrit në 38.1 përqind (26.3 përqind në vitin 2019). Rritja e theksuar e këtyre dy kategorive ndaj totalit të investimeve brenda vendit i atribuohet alokimit të 120 milionë euro në tregun e jashtëm, të cilat në vitin 2018 figuronin në kategorinë e parasë së gatshme (ishin mjete në tranzit – për investim jashtë vendit).

Përkundër që pjesëmarrja e investimeve brenda vendit shënoi rënie këtë vit në 24.8 përqind nga 27.0 përqind sa ishte në vitin e

kaluar, ajo vazhdon të jetë dyfish më e lartë se para dy viteve (grafik 77.) Dinamikat në investimet e FKPK-së në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës varen nga kërkesa dhe shuma e ofruar e Qeverisë, si dhe nga konkurrenca në ankande. Në fund të dhjetorit 2019, vlera e aseteve të FKPK-së arriti në 1.97 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.0 përqind (rritje vjetore prej 2.2 përqind në vitin 2018).

Në vitin 2019, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 8.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 17.6 përqind. Arkëtimet e reja arritën vlerën në 549.9 mijë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.7 përqind (grafik 78).

Grafik 78. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale




Pjesa më e madhe e aseteve të FSKP-së vazhdon të investohet jashtë vendit, përkatësisht 84.7 përqind e gjithsej aseteve. Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve (77.3 përqind), letrave me vlerë (15.0 përqind), dhe parasë së gatshme (6.2 përqind). Në anën tjetër, investimet në Kosovë u zvogëluan për 0.7 pikë përqindje, me pjesëmarrje prej 15.0 përqind të gjithsej aseteve të FSKP-së. Mundësitë e limituara për të investuar në tregun e brendshëm bënë që mjetet e FSKP-së të jenë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (75.5 përqind), depozita në bankat komerciale (21.3 përqind) dhe pjesa e mbetur e mbajtur si para e gatshme në trezor të FSKP-së (3.2 përqind).

6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional shënoi performancë pozitive financiare gjatë vitit 2019, si rezultat i kthimit rekord nga investimet në tregun e jashtëm. FKPK kishte kthim në investime në vlerë prej 160.7 milionë euro (grafik 79). Si rezultat i performancës së mirë financiare, FKPK mbylli ditën e fundit të dhjetorit 2019 me çmim më të lartë të aksionit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Grafik 79. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Konkretisht, çmimi i aksionit u rrit në 1.51 euro në krahasim me 1.39 euro në dhjetor 2018. Kjo rritje e lartë e fitimit u ndikua nga shumë faktorë, siç janë një ambient më i favorshëm ekonomik në tregjet e huaja (investime kryesisht të koncentruara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës) gjatë vitit 2019, rrezikshmëri më e ulët nga recesionet ekonomike, zbutje të marrëdhënieve tregtare SHBA-Kinë, fitime të kënaqshme të korporatave, etj.

FSKP po ashtu shënoi kthim të lartë nga investimet në vitin 2019.

Kthimi bruto nga investimet arriti në 1.2 milionë euro në vitin 2019, krahasuar me kthimin negativ prej 221.0 mijë euro në vitin paraprak (grafik 80). Si rrjedhojë, edhe çmimi i aksionit të FSKP-së në ditën e fundit të muajit dhjetor 2019 shënoi rritje në 1.79 euro, krahasuar me 1.57 euro në periudhën paraprake.


Grafik 80. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve


Burimi: BQK (2020)

6.2 Sektori i Sigurimeve

6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në vitin 2019 shënoi rritje të aktivitetit dhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara. Megjithatë, këto zhvillime nuk u reflektuan në realizim të fitimit kryesisht si pasojë e rritjes së nivelit të dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve tjera relevante.


Grafik 81. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve


Burimi: BQK (2020)

Me një pjesëmarrje prej 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia. Niveli i ndërmjetësimit të sektorit (primet e shkruara bruto në raport me BPV-në) rezultojnë të ketë qenë në nivel pothuajse të pandryshuar me katër vitet paraprake, prej 1.4 përqind, e që vlerësohet si relativisht i ulët krahasuar me vendet e rajonit. Në anën tjetër, niveli i densitetit, që paraqet primet e shkruara për kokë banori, gradualisht ka shënuar rritje

ndër vite duke arritur në 54.8 euro në fund të dhjetorit 2019 (grafik 81).

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurveeve 'jo-jetë' që përfaqësojnë 91.0 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e sigurveeve 'jetë'. Numri i sigurveeve u zvogëlua krahasuar me vitin e kaluar si pasojë e revokimit të licencës së njëjës nga kompanitë e sigurimit. Rrjedhimisht, numri i kompanive të sigurimit u zvogëlua në 13, prej të cilave 11 janë sigurveeve jo-jete dhe 2 sigurveeve 'jetë'.

Grafik 82. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2019)



Burimi: BQK (2020)

Pothuajse gjysma e tregut të sigurimeve përfaqësohet nga sigurveetit vendor, dhe gjysma tjetër nga sigurveetit me origjinë të huaj. Revokimi i licencës së njëjës nga kompanitë e sigurimit me pronësi të huaj gjatë vitit 2019 rezultoi në rënie të pjesëmarrjes së aseteve të menaxhuara nga kompanitë me pronësi të huaj në 50.1 përqind (52.3 përqind në vitin 2018). Në kuadër të aseteve me pronësi të huaj, pjesëmarrjen më të lartë në vitin 2019 kishte Shqipëria, pasuar nga Sllovenia dhe Austria (grafik 82). Ndërsa, kompanitë e sigurimit me kapital vendor menaxhojnë 49.9 përqind të mjeteve të sektorit.

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një koncentrim të ulët, që është parakusht për funksionalizimin e një konkurrence më të madhe në treg, mirëpo me tendencë rritëse gjatë kësaj

periudhe. Indeksi i Herfindahl-it³⁷ i kalkuluar për primet e shkruara bruto për vitin 2019 tregon 930 pikë (për vitin 2018 ishte 870 pikë). Ndërsa, po i njëjti indeks i kalkuluar duke marr për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, përkatësisht 853 pikë për vitin 2019 nga 808 në vitin paraprak.

Grafik 83. Asetet e sektorit të sigurimeve




Në të njëjtën kohë, indeksi CR5³⁸ për prime në vitin 2019, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve rezulton 54.7 përqind (në vitin 2018 qëndronte në 52.8 përqind), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezulton me 50.8 përqind (në vitin 2018 qëndronte në 49.8 përqind). Sipas sektorëve, koncentrimi është më i lartë tek sektori i sigurimeve 'jetë', kjo si rezultat i numrit më të vogël të siguruesve në këtë sektor. Rritja e koncentrimin si në asete ashtu dhe prime ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të numrit të siguruesve nga 14 sa ishin në vitin e kaluar, në 13 sosh sa janë aktualisht.

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën në 196.5 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 11.8 përqind (grafik 83). Asetet e siguruesve 'jo-jetë' u rritën për 12.1 përqind, përderisa asetet në kuadër të siguruesve 'jetë' shënuan rritje vjetore prej 8.5 përqind.

Në kuadër të aseteve, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe të arkëtueshmet nga të siguruarit (debitorët e primeve) u karakterizuan me rritje të theksuar në vitin 2019.

Grafik 84. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve (dhjetor 2019)



Sidoqftë, paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale dhe BQK mbeten kategoria dominuese në bilancin e gjendjes së sektorit të sigurimeve me pjesëmarrje prej 49.5 përqind. Kjo strukturë e aseteve sugjeron se aktivi i siguruesve përmban përqindje të lartë të aseteve me likuiditet të lartë.


Struktura e investimeve të siguruesve, vazhdon të jetë konservative. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës rritën peshën në 14.1 përqind në vitin 2019, nga 13.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 84). Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë strukturën e përgjithshme (grafik 85). Provizionet teknike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të siguruesve në vitin 2019, shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind. Kryesisht, rritja e rezervave teknike u ndikua pozitivisht nga rritja vjetore prej 10.0 përqind e provizioneve për primet bruto, pasuar nga rezervat për dëmet bruto, që shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind.

³⁷ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000

– 1,800 njësi, niveli i koncentrimin në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

³⁸ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

Grafik 85. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2019)




Burimi: BQK (2020)

Vlera e gjithsej kapitalit të siguruesve u rrit për 7.6 përqind dhe arriti në 47.4 milionë euro. Rritja e kapitalit i atribuohet kryesisht rritjes së kapitalit aksionar të paguar, i cili u rrit për 10.2 milionë euro në vlerën e përgjithshme prej 84.1 milionë euro. Kurse, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite nga sektori arriti në 38.8 milionë euro, duke neutralizuar rritjen e mëtejme të gjithsej kapitalit, së bashku me neto humbjet e ndodhura gjatë vitit 2019.

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2019 arriti në 99.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 7.7 përqind (grafik 86). Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit “jo-jetë” të cilat përfaqësojnë 96.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara.

Grafik 86. Primet bruto të arkëtuara



Vlera prej 95.7 milionë euro e primeve të shkruara nga siguruesit “jo-jetë” ishte për 7.4 përqind më e lartë se në vitin 2018. Nga gjithsej 11 siguruesit “jo-jetë” gjatë këtij viti, 10 prej tyre shënuan rritje në nivelin e primeve

të shkruara bruto, ndërsa vetëm një sigurues u karakterizua me rënie vjetore të primeve të shkruara.

Sigurimet “jo-jetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 59.9 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara “jo-jetë”, ndërsa sigurimet vullnetare përbëjnë 40.1 përqind të gjithsej primeve të shkruara bruto “jo-jetë”.

Pjesëmarrja e sigurimeve të detyrueshme në gjithsej primet e shkruara krahasuar me vitin e kaluar shënoi rënie. Kjo rënie u ndikua nga niveli më i ulët i arkëtimeve nga polisat e kategorisë “MTPL” dhe “Sigurimeve kufitare”. Ndërsa, sigurimet vullnetare shënuan rritje prej 12.3 përqind, duke rritur kështu edhe pjesëmarrjen në gjithsej primet e shkruara bruto. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve vullnetare në gjithsej primet e shkruara bruto u ndikua nga rritja e primeve për produktet si “Aksidenti dhe Shëndeti”, “Kasko”, “Kreditë dhe Garancionet” dhe produktet tjera që shënuan rritje më të ngadalësuar (tabela 8).

Në vitin 2019, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 3.5 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 17.0 përqind krahasuar me vitin 2018.

Në tabelën 9 janë të shpalosura statistikat për dëmet e ndodhura gjatë kësaj periudhe, vlera e të cilave arriti në 48.0 milionë euro, nga 42.8 milionë euro sa ishin në vitin e kaluar. Kjo rritje e vlerës së dëmeve të ndodhura i atribuohet produkteve të sigurimit të detyrueshëm dhe atij vullnetar. Në kuadër të produkteve të sigurimit të detyrueshëm, të gjitha kategoritë e saj shënuan rritje, por që ishte më e theksuar tek kategoria e “MTPL-ve”. Kurse, sa i përket sigurimit vullnetar, përjashtuar kategorinë “aksident dhe shëndet”, të gjitha kategoritë tjera u rritën, me theks të veçantë kategoria “sigurime në pronë”.

Tabela 8. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2018	2019	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2018	Pjesëmarrja: 2019
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	89.1	95.7	7.4%	96.8%	96.5%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	45.3	47.0	3.7%	49.2%	47.3%
TPL+	2.3	2.5	9.5%	2.5%	2.5%
Sigurime kufitare	7.4	8.0	7.0%	8.1%	8.0%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	18.0	19.6	8.6%	19.6%	19.8%
Kasko	4.5	5.4	21.4%	4.9%	5.5%
Kredi dhe garancione	3.6	4.5	25.0%	3.9%	4.5%
Sigurime në pronë	5.4	5.3	-1.1%	5.8%	5.3%
Sigurime nga humbjet financiare	1.0	1.2	20.3%	1.1%	1.2%
Sigurimi i përgjegjësisë	1.6	2.2	36.6%	1.7%	2.2%
Marinë dhe transport	0.1	0.2	56.8%	0.1%	0.2%
<i>Gjithsej jetë</i>	3.0	3.5	17.0%	3.2%	3.5%
Gjithsej tregu	92.1	99.2	7.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2020)

Tabela 9. Dëmet e ndodhura, sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2018	2019	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2018	Pjesëmarrja: 2019
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	42.3	47.2	11.6%	98.7%	98.5%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	23.5	24.8	5.7%	54.8%	51.8%
TPL+	0.2	0.7	233.3%	0.5%	1.5%
Sigurime kufitare	2.3	2.8	20.8%	5.4%	5.8%
Marrëveshja MoU	0.3	0.4	38.7%	0.6%	0.8%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	10.4	10.0	-4.5%	24.3%	20.8%
Kasko	2.9	3.1	10.0%	6.7%	6.5%
Kredi dhe garancione	0.1	0.8	505.3%	0.3%	1.7%
Sigurime në pronë	2.5	3.6	42.1%	5.9%	7.5%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.1	1.0	1153.7%	0.2%	2.1%
<i>Gjithsej jetë</i>	0.6	0.7	30.0%	1.3%	1.5%
Gjithsej tregu	42.8	48.0	11.9%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2020)

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje të përsheptuar vjetore prej 14.1 përqind dhe arritën vlerën prej 55.1 milionë euro në vitin 2019. Rritja më e lartë e dëmeve të paguara gjatë vitit 2019 krahas rritjes më të vogël të primeve të shkruara rezultoi në rritje të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (grafik 87).


6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat negativ financiar prej 3.8 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së dëmeve të ndodhura nga siguruesit jo-jetë.

Siguruesit “jetë” vazhdojnë të gjenerojnë rezultate pozitive financiare, prej 460.5 mijë euro krahasuar me 584.4 mijë euro në vitin 2018. Ndërsa, siguruesit “jo-jetë” shënuan humbje prej 4.2 milionë euro, krahasuar me

fitimet prej 1.0 milionë euro në vitin 2018. Ky rezultat financiar pasqyron rritjen më të lartë të dëmeve të ndodhura prej 14.2 përqind, kundrejt rritjes së të hyrave neto nga primi prej 3.7 përqind, dhe njëkohësisht, rritjes vjetore të shpenzimeve operative të sektorit prej 6.5 përqind.

Grafik 87. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Një ndër faktorët kryesor në humbjet e realizuara gjatë vitit 2019 ishte raporti i kombinuar në masë prej 104.0 përqind, i cili paraqet raportin e dëmeve prej 55.7 përqind dhe raportin e shpenzimeve prej 48.4 përqind (pa përfshirë të hyrat nga interesat e investimeve), raport që sugjeron se për 1 euro të fituar tregu i sigurimeve ka shpenzuar 1.04 euro.

Bazuar në Rregulloren për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve, siguruesit janë të detyruar të mbajnë asete të mjaftueshme në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike jo më pak se vlera bruto e provizioneve teknike, respektivisht matematike.

Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në nivel prej 96.6 përqind në vitin 2019 nga 97.2 përqind në vitin e kaluar. Po ashtu, edhe raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 83.8 përqind nga 87.3 përqind në vitin 2018.

³⁹ Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.


6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të konsiderueshme edhe në vitin 2019, por ritmi i rritjes u ngadalësua për herë të parë në pesë vitet e fundit.

Zgjerimi i aktivitetit kryesisht bazohet në financim të aktivitetit kredidhënës dhe lizingjeve. Financimi i tyre vazhdon të mbështetet kryesisht nga huazimet prej sektorit të jashtëm, dhe në masë më të vogël nga kapitali vetanak. Në vitin në vijim, përhapja e pandemisë Covid-19 pritet të ndikoj në ritmin e rritjes së sektorit financiar përmes zvogëlimit të portfolios kreditorë për ndërmarrjet edhe ekonomitë familjare, si rezultat i rritjes së rrezikut në realizimin e të ardhurave. Efektet negative të pandemisë dhe krizës ekonomike të shkaktuar si pasojë, pritet të shfaqen edhe në cilësinë e portfolios kreditorë.

Grafik 88. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Asetet e sektorit arritën vlerën prej 309.1 milionë euro në vitin 2019, që korrespondon me rritje vjetore prej 23.6 përqind, një ngadalësim të rritjes për herë të parë në pesë vitet e fundit (grafik 88). Në tregun vendor operojnë 20 institucione mikrofinanciare,³⁹ nga të cilat 12 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 93.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Si pasojë e revokimit të regjistrimit të dy institucioneve


mikrofinanciare, krahasuar me vitin e kaluar, niveli i koncentrimin të tregut është rritur.

Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,476 pikë në dhjetor 2019, që paraqet rritje të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,376 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u rrit në 55.4 përqind, nga 53.1 përqind sa ishte në vitin 2018.

Kreditë përbëjnë 71.7 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 17.0 përqind (grafik 89).

Krahasuar me vitin paraprak, pesha e lizingjeve në gjithsej asetet e sektorit është rritur kundrejt rënies së kategorisë së kredive. Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet që përbëjnë 65.5 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbën 65.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit.

Grafik 89. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar (dhjetor 2019)



Burimi: BQK (2020)


Edhe gjatë vitit 2019, huamarrjet nga sektori i jashtëm vazhduan të ruajnë ritmin e rritjes në vlerë dyshifrore, por rritja ishte dukshëm më e ulët se në vitin e kaluar. Vlera e huamarrjeve nga sektori i jashtëm arriti në 197.0 milionë euro në vitin 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 17.0 përqind (28.6 përqind në 2018).

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2019 arriti në 221.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 20.5 përqind krahas rritjes prej 27.7 përqind

në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky është vitit i pestë me radhë i rritjes dyshifrore të aktivitetit kreditues prej institucioneve mikrofinanciare. Rritja e kreditimit u mbështet kryesisht prej rritjes së burimeve të financimit të institucioneve mikrofinanciare (kryesisht nga sektori i jashtëm, dhe nga rritja e kapitalit vetanak ndikuar nga fitimi i realizuar gjatë vitit dhe fitimi i mbajtur prej viteve të kaluara).

Në katër vitet e fundit, institucionet mikrofinanciare u orientuan më shumë drejt kreditimit të ekonomive familjare, megjithëse edhe kreditimi ndaj korporatave jofinanciare shënoi rritje të konsiderueshme. Konkretisht, kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2019 përfaqësuan 67.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar dhe shënuan rritje vjetore prej 23.3 përqind (31.7 përqind rritje vjetore në vitin 2018). Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' dominojnë strukturën e këtyre kredive, me një pjesëmarrje prej 49.3 përqind në vitin 2019.

Grafik 90. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit




Burimi: BQK (2020)

Kreditë ndaj korporatave jofinanciare përfaqësojnë 32.5 përqind të gjithsej stokut të kredive aktive. Në vitin 2019, këto kredi u karakterizuan me rritje vjetore prej 15.3 përqind (20.6 përqind rritje vjetore në vitin 2018). Ngjashëm me kreditë e ekonomive familjare, kreditë e lëshuara për korporatat jofinanciare vazhdojnë të kenë kryesisht maturim 'mbi 2 deri në 5 vite' me një pjesëmarrje prej 65.7 përqind (grafik 90).

Struktura e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarive ekonomike, ishte e ngjashme me vitet e kalaura. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon mbështetjen më të madhe me pjesëmarrje prej 26.3 përqind të gjithsej kredive ndaj korporatave jofinanciare. Kategoritë tjera me qasje të lartë në financim mikrofinanciar janë kreditë e destinuar për sektorin e ndërtimtarisë, tregtisë dhe industrisë (grafik 91). Mirëpo, krahasuar me pjesëmarrjen në tregun bankar, kreditë ndaj sektorit të tregtisë në institucionet mikrofinanciare kanë peshë më të ulët.

Sa i përket ecuresë, kreditë për sektorin e industrisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore. Rritje të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i bujqësisë dhe i ndërtimtarisë. Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të tregtisë shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes krahasuar me vitin e kaluar (grafik 92).

Grafik 91. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2019)




Burimi: BQK (2020)

Aktiviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi rritje të konsiderueshme. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar u rrit në 52.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 38.5 përqind (grafik 93). Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej lizingjeve e kishin lizingjet ndaj korporatave jofinanciare, të cilat janë dhe kategoria dominuese, vlera e të cilave u rrit për 46.2 përqind krahasuar me vitin e kaluar.


Lizingjet për ekonomitë familjare kanë një pjesëmarrje prej 46.6 përqind në strukturën e përgjithshme të gjithsej lizingjeve.

Grafik 92. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik



Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, lizingjet hipotekare, që përfaqësojnë kategorinë dominuese, shënuan rritje për 15.7 përqind.

Grafik 93. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar




Lizingjet tjera në kuadër të ekonomive familjare shënuan rritje të konsiderueshme vjetore prej 51.0 përqind, megjithëse pjesëmarrja në gjithsej lizingjet është e kufizuar. Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 48.4 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 32.8 përqind.

Në kuadër të lizingjeve për korporatat jofinanciare, lizingjet tjera, të cilat edhe dominojnë lizingjet për korporata jofinanciare, u karakterizuan me rritje prej 43.0 përqind. Po ashtu, dhe lizingjet për pajisje shënuan rritje,

nga 2.3 milionë euro sa ishin në vitin 2018 në 3.8 milionë euro në fund të vitit 2019. Sipas maturitetit të lizingjeve për korporatat jofinanciare, pjesa më e madhe dominohet nga lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 89.1 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘prej 1 deri 2 vite’ me pjesëmarrje prej 4.6 përqind.

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënoi rënie të lehtë, duke zbritur në 20.5 përqind në fund të vitit 2019 (grafik 94). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizuan sektori i ekonomive familjare, kurse normat e interesit në kredi për korporatat jofinanciare shënuan rritje.


Grafik 94. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar në 21.5 përqind në fund të vitit 2019. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rrit në 19.1 përqind (grafik 94). Në kuadër të këtyre kredive, sektori i shërbimeve mban normën mesatare më të ulët të interesit prej 16.7 përqind, megjithëse krahasuar me vitin e kaluar shënoi rritje për 2.2 pikë përqindje. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rënie për 1.4 pikë përqindje, duke qëndruar në 21.4 përqind në fund të vitit 2019.

Po ashtu, edhe norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë regjistroi rënie për 0.5 pikë përqindje, në 20.3 përqind në fund të vitit 2019 (grafik 95).


Grafik 95. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar është karakterizuar me performancë mjaftë të mirë financiare, nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të kënaqshme të tyre me provizione. Në vitin 2019, profiti i realizuar arriti vlerë rekorde prej 11.5 milionë euro, krahasuar me profitin prej 9.7 milionë euro në vitin paraprak. Rritja e profitit erdhi si rrjedhojë e nivelit më të lartë të arkëtimeve krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuara.

Grafik 96. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Të hyrat e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën prej 56.4 milionë euro, e që është më e lartë për 13.6 milionë euro krahasuar me vitin e kaluar (grafik 96). Kjo rritje e të hyrave erdhi kryesisht prej të hyrave nga interesi në kredi. Shpenzimet e sektorit arritën vlerën në 44.9 milionë euro, për 11.9 milionë euro më lartë krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje e shpenzimeve ishte kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve për provizionim të humbjeve të

mundshme nga kreditë dhe shpenzimeve të personelit.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar rritje të konsiderueshme, prej 2.4 pikë përqindje, si rezultat i rritjes më të lartë vjetore të shpenzimeve krahasuar me rritjen e të hyrave. Në fund të vitit 2019, ky indikator qëndroi në 79.7 përqind nga 77.3 përqind në fund të vitit paraprak.

Profiti i realizuar gjatë vitit 2019, edhe pse në vlerë rekorde, nuk arriti të ndikoj në përmirësim të tregueseve të profitabilitetit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) qëndroi në nivel prej 4.0 përqind (4.3 përqind në vitin 2018), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 16.9 përqind (17.3 përqind në vitin 2018) (grafik 97). Kjo dinamikë kryesisht reflekton zgjerimin e theksuar të asetëve në vitet e fundit krahasuar me ecurinë e fitimit të realizuar.


Grafik 97. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2020)

Sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese. Kreditë me probleme shënuan rritje, megjithëse raporti i tyre ndaj gjithsej kredive qëndron në nivel të ulët dhe janë mirë të mbuluara me provizione (grafik 98). Niveli i kredive joperformuese në vitin 2019 qëndroi në 2.6 përqind (2.2 përqind në vitin 2018). Kurse, mbulueshmëria e tyre me provizione në vitin 2019 arriti në 190.9 përqind (226.0 përqind në vitin 2018).

Grafik 98. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2020)

Sektori i ndihmësve financiar përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.2 përqind të gjithsej asetëve. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Vlera e asetëve të ndihmësve financiar në vitin 2019 arriti në 16.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.8 përqind.

Të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rritje vjetore prej 7.9 përqind dhe arritën vlerën në 8.3 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 68.1 përqind), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 1.1 përqind. shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 10.3 përqind, duke arritur vlerën në 5.1 milionë euro. Neto fitimi i realizuar nga këto institucione financiare në vitin 2019 arriti në 3.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.5 përqind.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Sistemi i pagesave luan rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tij paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SPN në vitin 2019 arriti në 12.4 milionë (11.5 milionë në vitin 2018), duke shënuar rritje vjetore prej 8.1 përqind. Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara arriti në 14.14 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore

prej 9.1 përqind. Pagesat e rregullta masive dhe pagesat prioritare masive përfaqësuan rreth 78.4 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 10). Pagesat prioritare masive përfaqësojnë rreth 4.9 milionë transaksione të realizuara (39.1 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Ngjashëm, pagesat masive të rregullta, përfaqësojnë rreth 4.9 milionë transaksione të realizuara (apo 39.3 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj. Ndërsa 0.6 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 10).

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2018	2019	2018	2019
Të rregullta	13.4%	12.9%	11.3%	10.9%
Prioritare	1.0%	3.2%	36.6%	39.5%
Të rregullta - masive	40.2%	39.3%	5.7%	5.8%
Prioritare - masive	40.2%	39.1%	8.1%	8.4%
Pagesat xhiro	5.0%	5.2%	9.1%	8.6%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	6.4%	5.2%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.1%	0.0%	22.7%	21.5%
Te kthyera	0.1%	0.3%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2020)

Sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, kategori që arriti vlerën në 5.58 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 3.04 miliardë euro gjatë vitit 2019. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁴⁰ në vitin 2019 arrin në 2.15 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 4.7 përqind. Zhvillimi i

infrastrukturës virtuale është duke u bërë me ritëm të shpejtë dhe të sigurt. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar të rriten. Në vitin 2019 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 303.6 mijë⁴¹ (tabela 11). Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 84.3 përqind të gjithsej llogarive E-banking, pasuar nga ato afariste me pjesëmarrje prej 15.7 përqind.

⁴⁰ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

⁴¹ Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të numrit të llogarive të qasshme (aksessueshme) nga interneti.

Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019
Numri i degëve bankare	45	45	46	47
Numri i nëndegëve bankare	207	183	166	159
Numri i ATM-ve	522	512	491	497
Numri i POS-ve	10,589	11,501	13,183	13,769
Numri i llogarive 'e-banking'	230,905	301,841	250,733	303,602

Burimi: BQK (2020)

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 9.1 përqind në vitin 2019 krahasuar me vitin e kaluar. Në kuadër të kartelave, numri i kartelave me funksion debiti arriti në 1,108,355 kurse me funksion krediti në 184,718. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 9.5 përqind, përderisa kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 6.5 përqind.

Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat Visa (60.8 përqind) pasuar nga ato Master Card (37.0 përqind), kurse kartelat lokale kishin një pjesëmarrje prej 2.2 përqind. Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit së pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) përderisa numri i bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) është rritur krahasuar me vitin e kaluar, por krahasuar me vitin 2016 dhe 2017 ka më pakë ATM të shtrirë në vend. (tabela 12).

Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019
ATM tërheqje në para të gatshme	63.4%	61.9%	58.9%	59.5%
ATM depozitime	26.5%	29.3%	30.9%	29.9%
Kredit transference nëpërmjet ATM	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%
Tërheqje cash në terminale POS	0.3%	0.2%	0.2%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	9.9%	8.5%	9.8%	10.3%

Burimi: BQK (2020)

Numri i tërheqjeve përmes ATM-ve është rritur në 17.2 milionë (15.2 milionë në vitin 2018), me një qarkullim prej 2.75 miliardë euro (2.36 miliardë euro në vitin 2018). Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela qëndroi në nivel prej 59.5 përqind në vitin 2019, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Rritja e numrit të ATM-ve, të cilët mundësojnë depozitim të parave në

llogaritë e klientëve, ka ndikuar që vlera e depozitimeve të rrisë pjesëmarrjen në 29.9 përqind të gjithsej vlerës së transaksioneve me kartela përmes terminaleve, nga 26.5 përqind sa ishte tri vite më parë (tabela 12). Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në terminalet POS arriti në 13.6 milionë në vlerë prej 476.8 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2019 arriti në 10.3 përqind.

8. Korniza për Makroprudencë

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë, e cila tashmë është publikuar në faqen zyrtare të BQK-së.

Me qëllim të përforcimit të bazës ligjore të BQK-së në ushtrimin e mandatit për makroprudencë, draft ligji i ri për banka që pritet të procedohet për aprovim në vitin 2020, përcakton BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale të bankave. Gjithashtu, ligji i ri i jap autoritet

BQK-së të nxjerrë instrumente rregullative përkatëse.

8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës

Gjatë tërë vitit 2019, dinamikat e përgjithshme në tregues të zgjedhur të makroprudencës në Kosovë u karakterizuan me qëndrueshmëri, duke rezultuar në parametra lartë mbi kërkesat rregullative.

Përkundër zgjerimit të ndërmjetësimit financiar, konkretisht, rritjes dyshifrore të kreditimit, cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar vazhdoi të jetë e lartë dhe me trend përmirësimi. Pjesëmarrja e kredive jo-performuese (KJP) ndaj gjithsej kredive vazhdoi të ndjekë trend rënës, nivel që rezulton më i ulët në nivel rajoni dhe nën mesataren e Bashkimit Evropian. Krahas ngritjes së cilësisë së portofolit kreditor, është shënuar rritje e normës së mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione për humbje nga kreditë, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë.

Sektorit bankar në tërësi por edhe bankat sistemike në veçanti vazhdojnë të mbeten mirë të kapitalizuara dhe likuide gjatë kësaj periudhe. Raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar dhe bankat

sistemike qëndrojnë lartë mbi kërkesat rregullatore. Kapitalizimi i mirë i sektorit bankar mbështetet edhe nga analiza e alokimit të kapitalit shtesë në raport me shkallën e rëndësisë sistemike të bankave.

Ngjashëm me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti i levës së gjithsej sektorit bankar dhe i bankave me rëndësi sistemike vazhdoi të mbetet mbi kërkesat minimale ligjore. Indikatorët e likuiditetit ishin në nivel të kënaqshëm, në veçanti raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta që ishte mbi kërkesat rregullative. Koncentrimi i ekspozimeve të mëdha në sistem bankar qëndroi në nivel adekuat me tendencë uljeje.

Treguesit e profitabilitetit, në veçanti Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), qëndroi në nivel të lartë, përderisa hendeku Kredi/BPV (anglisht: *credit to GDP gap*), megjithëse është zgjeruar në vitin 2019, jep sinjale se sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron. Në vitin 2019, sektori bankar rezultoi të ketë pesë banka me rëndësi sistemike, përderisa rezultatet e analizës stres-test për këto banka në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit bankar për të përballuar situata ekstreme të ekspozimit ndaj rrezikut të tregut apo rrezikut të likuiditetit.

Edhe analiza e përgjithshme e treguesve të shëndetit të sektorit të sigurimeve, si indikatorë potencialisht të rëndësishëm për makroprudencën, sugjeron që stabiliteti financiar i Kosovës nuk kërcënohet nga sektori i sigurimeve, marrë parasysh peshën e vogël të sektorit në sistem financiar. Gjithashtu, ndërlikohja në mes të sektorit të sigurimeve dhe atij mikrofinanciar dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve ndërmjet segmenteve të ndryshme të sistemit financiar të Kosovës.

8.2. Kapitali shtesë kundërciklik

Kapitali shtesë kundër-ciklik ka për qëllim forcimin e stabilitetit financiar përmes

mbrojtjes së sektorit bankar ndaj humbjeve që mund të shkaktohen nga akumulimi i rrezikut sistemik ciklik në një ekonomi, si dhe përmes ndikimit në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofertës kreditore përgjatë gjithë ciklit financiar. Kapitali shtesë kundër-ciklik është pjesë e kornizës rregullative të Bazeli III dhe njëherit një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar dimensionin ciklik të rrezikut sistemik.

Duke rritur kërkesat për kapital në kohën kur kreditimi është në fazën e rritjes përtej fundamentaleve të ekonomisë (rritet në shpejtësi më të madhe se sa bruto prodhimi i një vendi dhe perceptohet si rritje e tepërt e kreditimit), ky instrument synon rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit (solvensës së bankave) për të përballuar situatat e stresit financiar që mund të pasojnë nga akumulimi i rrezikut si rezultat i rritjes së tepërt të kreditimit. Njëherit, ky instrument ndihmon që në periudha të stresit financiar të nxisë kreditimin, përmes liritimit të rezervave të kapitalit të akumuluar gjatë fazës së rritjes së kreditimit dhe kushteve të mira ekonomike, me qëllim të evitimit të bartjes së pasojave negative të rënies së kreditimit në gjithsej sektorin financiar dhe ekonominë e vendit.

Për llogaritjen e kapitalit shtesë kundër-ciklik, udhëzimet e Komitetit për Mbikëqyrje Bankare të Bazelit⁴² sugjerojnë monitorimin e disa parametrave për vlerësimin nëse kreditimi është duke u rritur përtej fundamentaleve të qëndrueshme dhe rrjedhimisht është duke ndikuar në akumulimin e rrezikut sistemik. Krahas vlerësimit të parametrave sipas udhëzimeve përkatëse, autoritetet relevante duhet të gjykojnë relevancën e aplikimit të kërkesave kundër-ciklike të kapitalit.

BQK, në Politikën për Makroprudencë⁴³, liston instrumentin e kërkesave kundër-ciklike të kapitalit si instrument të mundshëm të objektivitetit të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale për zvogëlimin dhe

parandalimin e rritjes së tepruar të kredive dhe të levës. Konform udhëzimeve të Bazelit, parametri kryesor për përcaktimin e normës së KCK-së theksohet të jetë hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (BPV) në Kosovë, krahas tregueseve të tjerë relevant që do të informojnë vendimin përfundimtar për aktivizimin e mundshëm të instrumentit.

Në vijim, paraqitet i ashtuquajtimi model për vlerësimin e kërkesës për kapital kundër-ciklik për sektorin bankar të Kosovës. Devijimi i raportit të kreditimit ndaj BPV-së nga trendi i tij afat-gjatë paraqet parametrin kryesor të modelit. Llogaritja e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së bëhet duke u mbështetur në udhëzimet e Bazelit si dhe praktikatat e unifikuara të mënyrës së kalkulimit nga shumica e vendeve në botë të bazuara në rekomandime nga hulumtimet empirike, përmes filterit të njëanshëm Hodrik-Prescott (parametri zbutës 400,000).

Në kreditim janë përfshirë kreditë ndaj sektorit privat⁴⁴ nga bankat si dhe institucionet financiare jo bankare. Këto të fundit, megjithëse në pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin, janë duke u rritur më normë të lartë të rritjes dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen në sektorë të caktuar. Andaj, përfshirja e kredive të sektorit jo bankar përkundër që ka pjesëmarrje të ulët dhe aktualisht pa ndonjë efekt të theksuar në rezultat të hendekut të kreditimit, siguron konsistencë në mënyrën e llogaritjes me vendet tjera, si dhe siguron që të përfshihen efektet e rritjes së mundshme të peshës së kreditimit ndaj sektorit privat nga institucionet financiare jo bankare. Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së në Kosovë në vitin 2019 qëndroi në 45.8 përqind. Ndërsa, rezultatet e hendekut të kreditimit në fund të vitit 2019 sugjerojnë që sektori privat në Kosovë asnjëherë nuk ka kaluar nëpër periudhë të 'mbi kreditimit'.

Sidoqoftë, rritja më e shpejtë e kreditimit në raport me BPV-në në vitet e fundit ndikoi që


⁴² Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit, dhjetor.

⁴³ BQK (2018). *Politika për Makroprudencë, Prishtinë, qershor.*

⁴⁴ Mospërfshirja e kredive të sektorit publik dhe kredive ndaj ndërmarrjeve financiare në llogaritjen e hendekut të kreditimit siguron që dinamikat në kreditim nuk ndikohet nga ndryshime të mundshme në kreditimin e sektorit publik apo sektorin financiar.

në dhjetor 2019 hendeku i kredisë ndaj BPV-së të arrijë në 0.261 përqind, më i zgjeruar në rrafshin pozitiv krahasuar me vitin e kaluar (-0.200 përqind në dhjetor 2018), (grafik 99).

Grafik 99. Hendeku i kreditimit




Zgjerimi pozitiv i hendekut të kredisë ndaj GDP-së nënkupton që kreditimi është duke u rritur me ritëm më të shpejtë kundrejt bruto produktit vendor, gjegjësisht që rritja e kreditimit ndaj sektorit privat nuk e justifikon mjaftueshëm rritjen e prodhimit të brendshëm vendor. Mirëpo, në rastin e Kosovës, rritja e theksuar e kreditimit në vitet e fundit krahasuar me ritmin e rritjes së BPV-së nuk duhet të konsiderohet që të jetë në nivel të tepruar. Kjo për faktin që sektori financiar në Kosovë është ende në fazë të hershme të zhvillimit dhe ekonomia e Kosovës është në fazën e rritjes së ndërmjetësimit financiar dhe konvergimit me vendet tjera; si dhe historiku i shkurtër i sektorit bankar me njëtrajtshmëri të zhvillimeve financiare, pa ndonjë periudhë të stresit, e vështirëson vlerësimin adekuat të ciklit të kreditimit në vend dhe të sinjalizimit të akumulimit të rrezikut sistemik. Rrjedhimisht në dhënien e një vlerësimi gjykues të ciklit kreditues duhet patjetër të konsiderohen edhe indikatorët e tjerët financiar dhe ekonomik dhe shumë më tepër gjykimi i ekspertëve. Megjithatë, kapitali shtesë kundërciklik përbën instrument adekuat, për adresimin e indikatorit të hendekut të kredisë, me qëllim të përforsimit të aftësisë përbaluese të sektorit bankar ndaj cikleve financiare.

Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është bërë sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti

i Bazelit me ç' rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të asetëve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind. Sipas rezultateve të mësipërme, që sugjerojnë se Kosova vetëm nga marsi i vitit 2019 ka tejkaluar lehtësisht në hendek pozitiv ndaj BPV-së dhe se vazhdon të jetë ende në periudhë graduale të thellimit të ndërmjetësimit financiar për të arritur së paku nivelin e vendeve të rajonit, deri më tani nuk janë paraqitur nevojat për kërkesë të mundshme të kapitalit kundër-ciklik (grafik 100).

Grafik 100. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Po ashtu, indikatorë tjerë relevant monitorohen në baza të rregullta krahas hendekut të kreditimit, të cilëve së bashku me informacionet kualitative dhe gjykimin e ekspertëve relevant, iu alokohet peshë e veçantë në formimin e gjykimit përfundimtarë rreth zhvillimeve në fushën e rrezikut sistemik dhe raportit të kredisë ndaj BPV-së. Këta indikatorë, ndër tjera, përfshijnë dinamikën e rritjes kreditore të përgjithshme dhe rritjen në sektorë specifik, ekspozimet kreditore në sektorë të veçantë, raportin e kredisë ndaj kolateralit, raportin e borxhit ndaj të hyrave, etj.

8.3. Bankat me rëndësi sistemike

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të dimensionit

strukturor dhe ndërsektorial të rrezikut sistemik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike (tabela 13).


Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit dhjetor 2019, sugjerojnë që pesë banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike (grafik 101).

Tabela 13. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë⁴⁵

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 25%)	Asetet (pa provizione)
Zëvendësueshmëria (pesha 25%)	Vlera e transaksioneve në raport me gjithësej vlerës së transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithësej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithësej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithësej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 25%)	Pjesëmarrja në gjithësej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithësej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (pesha 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2019)

Grafik 101. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike




Burimi: BQK (2020)

Të pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret përbërëse (tabela 16). Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,305 pikë bazë deri në 2,115 pikë bazë, që paraqet rënie të lehtë të shkallës së sipërme në krahasim me dhjetor të vitit të kaluar.

Mirëpo, në përgjithësi, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike, kanë rritur shkallën e pikëve sistemike, kundrejt rënies së shkallës së pikëve të bankave që nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Përkatësisht, ky ndryshim ishte më i theksuar në kriterin e ndërlidhjes dhe aktivitetit

ndërshtetëror/kompleksitetit, dhe më pak i shprehur në atë të madhësisë. Vetëm në kriterin e zëvendësueshmërisë, kishte rritje të shkallës së pikëve tek bankat e rëndësisë josistemike, kundrejt rënies së shkallës në bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike.

Grafik 102. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK (2020)

Kriteri i madhësisë – Pesë bankat të cilat kanë rëndësi të përgjithshme sistemike, rezultuan të rëndësishme sistemikisht në kriterin e madhësisë (grafik 102).

Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,150 pikë bazë në 2,206 pikë bazë. Dy nga këto banka u karakterizuan me rënie të rëndësisë sistemike në këtë kriter

⁴⁵ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull


'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

krahasuar me vitin paraprak, ndërsa tri të tjerat shënuan rritje.

Kriteri i zëvendësueshmërisë – pesë bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike rezultuan sistemikisht të rëndësishme në kriterin e zëvendësueshmërisë. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,088 pikë bazë në 2,378 pikë bazë (grafik 103).


Shumica e bankave kanë shënuar rritje të shkallës sistemike në këtë kriter krahasuar me vitin e kaluar, por që ishte më e evidentuar tek bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kjo u evidentua në secilën prej nënkategorive. Në përgjithësi, shkalla e agreguar e pikëve tek bankat josistemike shënoi rritje kundrejt rënies së agreguar të pikëve tek bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike. Kjo dinamikë u vu re në nënkategoritë e kreditimit për korporatat jofinanciare dhe ekonomive familjare, depozitave të ekonomive familjare, si dhe pjesëmarrjes në transaksionet ndërbankare - ku u shënuar rritje më të përshpejtuar tek bankat e vogla krahasuar me ritmin e rritjes tek bankat e mëdha.

Grafik 103. Kriteri i zëvendësueshmërisë




Kriteri i ndërlidhjes – Ky kriter karakterizohet me luhatjet më të mëdha ngase bankat mund të ndërrojnë me lehtësi bilancin e tyre ndaj institucioneve financiare, si dhe investimet në letrat me vlerë. Në dhjetor 2019, me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes rezultuan pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike.

Grafik 104. Kriteri i ndërlidhjes



Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,083 pikë bazë në 1958 pikë bazë (grafik 104). Bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike rritën shkallën e pikëve konsideroshëm kundrejt rënies së shkallës së pikëve tek bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit më të theksuar me bankat dhe institucionet jashtë vendit nga bankat e mëdha, krahasuar me nivelin më të ulët prej bankave të vogla.

Grafik 105. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit – Pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,021 pikë bazë në 2,626 pikë bazë (grafik 105).

Krahasuar me vitin paraprak, shkalla e rëndësisë sistemike ka shënuar rritje si rezultat i rritjes së detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm nga banka me rëndësi të përgjithshme

sistemike, kryesisht në formë të depozitave ndaj jorezidentëve dhe linjave kreditore.


Duhet theksuar se sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapital për bankat me rëndësi sistemike, mbi kapitalin e klasit të parë siç rekomandohet nga Bazel dhe ABE, nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit rregullator të sektorit bankar në Kosovë.

Andaj, modeli aktualisht shërben vetëm për monitorimin e dinamikës së rëndësisë sistemike dhe mbikëqyrjen më të informuar dhe adekuate të institucioneve konform rëndësisë së tyre sistemike, dhe nuk paraqet rekomandim për aplikim të shtesës së kapitalit për institucione me rëndësi sistemike vendore.


9. Shtojca Statistikore

Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës


Figura 1. Ekonomia e jashtme




Grafik 2. Ekonomia e brendshme



Grafik 3. Ekonomitë familjare




Grafik 4. Sektori i ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2020)

Grafik 5. Sektori qeveritar




Burimi: BQK (2020)

Grafik 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK (2020)

Grafik 7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK (2020)

Grafik 8. Lkuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK (2020)

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.9	18.1	17.0	15.9
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.9	16.2	15.5	14.2
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	2.2	1.2	1.5	1.5
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	4.9	3.1	2.7	2.0
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.4	0.2	0.2	0.2
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	63.9	63.6	63.4	63.3
	Ekonomitë familjare	35.7	36.2	36.3	36.4
	OJSHEF	0.02	0.01	0.01	0.03
	Jo-rezidente	0.02	0.02	0.01	0.03
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)*	2.4	2.8	2.3	2.1
	Kthimi në kapital (KNK)*	19.9	22.1	18.3	17.2
	Margjina e interesit ndaj te hyrave bruto	68.1	65.1	78.4	80.6
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	49.6	45.3	48.2	48.1
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	26.3	25.4	29.0	28.8
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	31.7	30.1	23.8	23.3
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	34.5	32.2	32.2	31.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	41.5	38.2	40.0	38.7
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	4.4	1.2	3.8	4.7
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	12.1	12.6	12.2	11.2
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	66.9	81.7	65.9	81.8
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	36.4	40.3	44.0	43.5
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	6.0	5.5	4.5	4.8
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	125.8	119.5	122.8	129.2
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.1	3.9	5.0	4.4

*Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org